



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 527 Akti**

**Nr. 565 Vendimi  
Tiranë më 26.9.2022**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Etleda Çiftja</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Pamela Qirko</b>	<b>Relatore</b>
<b>Suela Zhegu</b>	<b>Anëtare</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonçi Petkoviç, në datën 22.9.2022, ora 13:30, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Blerta Marku (Çibuku)**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b** dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

## I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5 i ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe, në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Blerta Marku (Çibuku), me funksionin gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në nenin 14, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, pas zhvillimit të procedurave të shpërndarjes së çështjeve me short në datën 15.6.2020, rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Alma Faskaj dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Alma Faskaj.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 22.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese Etleda Çiftja<sup>1</sup>, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

5. Bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.7.2022, Komisioni vendosi zëvendësimin me short të relatores Alma Faskaj, për shkak të mungesës për arsye objektive. Pas shpërndarjes me short, relatores çështjes u caktua komisionere Pamela Qirko, e cila deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit.

7. Proces i vlerësimit të pasurisë, në përputhje me kreun IV të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

8. Proces i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

9. Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në kuadër të kontrollit të pasurive/interesave privatë të subjektit të rivlerësimit është konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e pasurive;
- ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

10. Në vijim janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Proces i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm,

---

<sup>1</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. 1, datë 22.6.2020.

me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

**11.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimin të pasurisë, vlerësoi se ato arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe, në datën 28.7.2022 vendosi<sup>2</sup>: i) përfundimin e hetimit kryesisht, duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimin; ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimin për t'u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47 të ligjit 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**12.** Subjekti i rivlerësimin u njoftua nëpërmjet postës elektronike në datën 29.8.2022, në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ, analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe metodologjinë e përgatitjes së saj, në lidhje me të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime, të drejtën për të paraqitur prova të reja apo thirrjen e dëshmitarëve, duke i dhënë kohë për ushtrimin e këtyre të drejtave, brenda një afati të arsyeshëm prej 15 ditësh. Subjekti i rivlerësimin u njoh me të gjitha aktet e dosjes më 30.8.2022, duke disponuar kopjen e saj në format elektronik (CD).

**13.** Në datën 14.9.2022, subjekti paraqiti në formë elektronike shpjegimet dhe provat, si dhe njëkohësisht i depozitoi ato në protokollin e Komisionit<sup>3</sup>. Me prapësimet e dërguara, subjekti paraqiti kërkesë për riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera: atë të kontrollit të figurës dhe vlerësimin të aftësive profesionale, duke konsideruar se kishte arritur nivelin e besueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.

**14.** Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit, vendosi<sup>4</sup> mospranimin e saj, pasi ka vlerësuar se, deri në atë fazë të hetimit, provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimin të pasurisë kishin arritur nivelin e provueshmërisë, bazuar në nenin 4, pika 2 dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, nëse pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të depozituara me prapësimet e dërguara, si dhe pas parashtrimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore do të provohej e kundërta e rezultateve të hetimit, trupi gjykues do të vendoste për ecurinë e procesit të rivlerësimin. Vendimmarrja iu komunikua subjektit në datën 19.9.2022.

**15.** Në këtë kontekst, pas shqyrtimit të shpjegimeve të vëna në dispozicion, trupi gjykues vendosi<sup>5</sup> të ftojë subjektin e rivlerësimin në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me e-mailin e datës 19.9.2022.

**16.** Në datën 20.9.2022, subjekti i rivlerësimin depozitoi në Komision kërkesën<sup>6</sup> për përjashtimin nga trupi gjykues të anëtares Etleda Çiftja, bazuar në nenin 30/c të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.9.2022, të Komisionit, u ngrit me short trupi gjykues për marrjen në shqyrtim të kësaj kërkesë, i cili në përfundim vendosi mospranimin e saj.

**17.** Subjektit të rivlerësimin u njoftua për vendimin e referuar si më sipër, elektronikisht, me e-mailin e datës 21.9.2022, si dhe iu rikomunikua ftesa për zhvillimin e seancës dëgjimore në datën 22.9.2022 ora 13:30.

---

<sup>2</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. 2, datë 28.7.2022.

<sup>3</sup> Prapësimet e subjektit të rivlerësimin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2022.

<sup>4</sup> Vendim i ndërmjetëm nr. 3, datë 15.9.2022.

<sup>5</sup> Vendim i ndërmjetëm nr. 4., datë 15.9.2022.

<sup>6</sup> Kërkesa e depozituar nga subjekti, protokolluar në Komision me nr. \*\*\*prot., datë 20.9.2022.

## II. SEANCA DËGJIMORE

**18.** Seanca dëgjimore, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 22.9.2022, ora 13:30, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonçi Petkoviç.

**18.1.** Subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesja ligjore, znj. I.R, morën të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe pretendimet e tyre në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe mbi rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni riçeljen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera.

## III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

**19.** Znj. Blerta Marku ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

**20.** Proçesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**20.1.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**20.2.** Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

**20.3.** Ligji nr. 84/2016 ka përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, si dhe të proporcionalitetit, parime këto, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Në këtë ligj përcaktohet angazhimi i organeve kompetente ndihmëse në procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

**20.4.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**20.5.** Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017<sup>7</sup> dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

---

<sup>7</sup>41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**20.6.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja bashkë me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”, b) deklaratat periodike të dorëzuara nga subjekti ndër vite, si dhe aktet mbështetëse si dokumentacion bashkëlidhur raportit; c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private; d) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, si dhe nëpërmjet postës elektronike për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**21.** Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë edhe interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të<sup>8</sup>.

**21.1.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe verifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj.

**21.2.** Përtej këtij raporti dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion, i cili pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit.

**21.3.** Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, si edhe verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të deklaruara për krijimin e këtyre pasurive.

**21.4.** Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI më 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar këto pasuri (të luajtshme dhe të paluajtshme):

**22. Pasuri e llojit “apartament banimi”,** me sipërfaqe 87.93 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Gjirokastrë, blerë në datën 20.08.2003, në shumën 900,000 lekë. Subjekti ka deklaruar se kjo pasuri ka si burim kontributin e familjes dhe se ajo zotëron 50% pjesë takuese mbi të.

### **Deklarimi i kësaj pasurie në vite**

**22.1.** Në deklaratën fillesatare të pasurisë – deklarata mbi pasuritë dhe interesat private e vitit 2003, depozituar në ILDKPKI në datë 18.3.2004, në seksionin “Pasuri të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit “apartament banimi” 2+1, me sipërfaqe 110 m<sup>2</sup>, i ndërtuar pas viteve 1990, me vlerë 900,000 lekë. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri e cila është përfituar me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.8.2003, është e regjistruar në regjistrat hipotekorë (nr. pasurie \*\*\*) dhe se ajo zotëron 50% pjesë takuese mbi të.

---

*mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi.*

*Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”*

<sup>8</sup> Referuar nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

**22.2. Konkluzioni i ILDKPKI-së për këtë pasuri:** Konstatohet vlerë e ulët e apartamentit me sipërfaqe 87.93 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*\*”, blerë në vitin 2003, në vlerën 900,000 lekë.

### **Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri**

**23.** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës “Vetting”,<sup>9</sup> si edhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit të kryer për këtë pasuri rezultoi se, me kontratë shitjeje pasuri e paluajtshme<sup>10</sup>, në datën 20.8.2003, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, z. D.M, kanë blerë nga shtetasi S.J pasurinë e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 87.93 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Gjirokastrë<sup>11</sup>, për vlerën prej 900,000 lekë.

**23.1.** ASHK-ja, Drejtoria Vendore Gjirokastrë<sup>12</sup> konfirmon se, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, z. D.M, figuron e regjistruar<sup>13</sup> pasuria e llojit “apartament” me sipërfaqe 87,93 m<sup>2</sup>, e ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, me nr. pasurie \*\*\*, regjistruar në bazë të kontratës së shitjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.8.2003. Në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie, palët kanë deklaruar se pagesa e çmimit të shitjes është bërë dhe se prona është marrë në dorëzim nga pala blerëse.

**23.2.** Nisur edhe nga konstatimi i bërë nga ILDKPKI-ja, Komisioni kreu verifikime mbi çmimin e shitblerjes së kësaj pasurie. Në referim të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 8.05.2003, «Për miratimin e kosto mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “k”», kostoja mesatare e ndërtimit për vitin 2003, për objekte në qytetin e Gjirokastrës është në vlerën 28,967 lekë për metër katror. Nëse do të merrej për bazë kjo kosto mesatare ndërtimi, rezultoi se vlera e ndërtimit të pasurisë objekt vlerësimi paraqitet në shumën rreth 2.5 milionë lekë, pra më e lartë se vlera e përcaktuar në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie (sipërfaqe totale të ndërtimit për banim prej 87.93 m<sup>2</sup> \* kosto mesatare e ndërtimit 28,967 lekë = 2,547,859 lekë).

**23.3.** E pyetur nga Komisioni lidhur me dyshimet e ngritura për vlerën e blerjes së kësaj pasurie, çmimit të shënuar në kontratën e shitblerjes<sup>14</sup>, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *ajo dhe bashkëshorti, D.M, kanë blerë një apartament banimi nr. \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, pasuri kjo e regjistruar në ZVRPP Gjirokastrë, sipas vërtetimit hipotekor nr. \*\*\*, datë 26.4.2001. Ky apartament është pjesë e godinës masive, pallat shumëkatësh, i cili është regjistruar në emër të pronarit sipas aktit të kolaudimit, i cili cilëson se hipotekimi i pallatit shumëkatësh me sipërfaqe 460 m<sup>2</sup> është bërë në fazën e karabinasë. Pasuria blerë prej tyre është blerë në gjendjen “karabina”. Sipas përlllogaritjeve tekniko-inxhinierike faza e karabinasë përbën rreth 35% të vlerës së hyrjes së përfunduar. Në këtë mënyrë është proceduar edhe me banorë të tjerë të pallatit, sikurse vërtetohet me kontratat e shitjes së referuara në përgjigje të pyetësorit të Komisionit. Pra, të gjitha hyrjet e këtij pallati janë blerë në karabina dhe në vlera të përafërta me vlerën e blerë prej saj dhe bashkëshortit. Sqaron se shitja në karabina nga ana e ndërtuesve dhe përfundimi i punimeve nga vetë blerësit e apartamenteve, ishte një praktikë shumë e përdorur të paktën në qytetin e Gjirokastrës në atë periudhë. Çmimi i EKB-së bën fjalë për send të përfunduar e gati për banim, jo për send në fazën e karabinasë.*

**23.4.** Në përgjigjet e dhëna mbi këtë çështje, subjekti ka referuar se, në mbështetje të deklarimeve të bëra, ka depozituar dokumentacionin shkresor si vijon: i) shkresën e ASHK-së, Drejtoria

<sup>9</sup> Ndodhur në aneksin \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>10</sup> Kontratë shitjeje pasuri e paluajtshme apartament, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.8.2003, redaktuar nga noteri publik, znj. A.P.

<sup>11</sup> Pasuria me nr. \*\*\*, e ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*, apartamenti nr. \*\*\*, kati i dytë, shkalla e parë, pallati \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Gjirokastrë.

<sup>12</sup> Shkresa e ASHK-së, Drejtoria Vendore Gjirokastrë me nr. \*\*\* prot., datë 18.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2020).

<sup>13</sup> Vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. \*\*\*, datë 16.10.2003.

<sup>14</sup> Pyetja nr. 2 e pyetësorit nr. 2.

Vendore Gjirokastër me nr. \*\*\* prot., datë 26.01.2022; ii) kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.06.2001; iii) kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 03.05.2001; (iv) kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.07.2001; dhe v) aktekspertimi nga Ing. E.L.

**23.5.** Por, Komisioni konstatoi se bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, subjekti nuk e ka depozituar shkresën e ASHK-së Gjirokastër me nr. \*\*\* prot., datë 26.01.2022, nëpërmjet të cilit kërkon të provojë se është bërë në fazën karabina hipotekimi i pallatit ku ndodhet apartamenti objekt vlerësimi.

**23.6.** Nëpërmjet aktekspertimit, bazuar në pyetjen e bërë nga subjekti, inxhinierja E.L ka shpjeguar se, në bazë të ligjit nr. 120/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimeve”, të ndryshuar, e konkretisht në nenin 3, pika 7, përcaktohet se “Karabina” është objekti i ndërtuar plotësisht në volum dhe në formë, sipas kushteve urbanistike të miratuara për konstruksionin dhe muraturën perimetrale. Në vijim, ekspertja ka referuar se në “Karabina”, futen elementet përbërëse të objektit, të cilët janë themelet, kolonat, trarët, soleta, kafazi i shkallëve dhe muret perimetralë. Sipas ekspertes, karabinaja e objektit zë rreth 35% të kostos totale të objektit.

**23.7.** Ndërsa, nga verifikimi i kontratave të shitblerjes të depozituara nga subjekti konstatohet se në të njëjtin objekt janë shitur nga S.J, pasuritë me të dhënat përkatëse, datën e shitjes dhe për vlerat si vijon: i) në datën 13.5.2001 është shitur pasuria e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 93.56 m<sup>2</sup>, në vlerën 600,000 lekë; ii) në datën 28.6.2001 është shitur pasuria e llojit “njësi shërbimi” (dyqan) me sipërfaqe 88 m<sup>2</sup>, në vlerën 770,000 lekë; dhe iii) në datën 19.7.2001 është shitur pasuria e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 82.86 m<sup>2</sup>, në vlerën 700,000 lekë.

**23.8.** Nga hetimi administrativ, Komisioni konstatoi se nga llogaria bankare e personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT), përgjatë vitit 2012 e në vijim janë kryer pagesa të ndryshme për shërbime utilitare, midis tyre dhe një pagesë për kotratën nr. \*\*\*, me përshkrimin “A sh.a”. Pas verifikimeve të kryera<sup>15</sup> rezultoi se, në datën 21.10.2003, bashkëshorti i subjektit, ka lidhur kontratë shërbimi me operatorin “A” sh.a., për pajisjen me numër telefonik fiks, për apartamentin e ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Gjirokastër. Pra, konstatohet se kjo kontratë është lidhur rreth 2 muaj pas blerjes së apartamentit.

**23.9.** Në vlerësim të kësaj rrethane, faktit se kontratat e tjera për shitjen e pasurive në të njëjtin objekt, të depozituara nga subjekti, janë kryer në vitin 2001, pra jo në vitin 2003 kur e ka blerë subjekti, si edhe për sa kohë subjekti nuk deklaroi investimet dhe shpenzimet e kryera mbi këtë pasuri, si edhe në mungesë të depozitimit të situacioneve për kryerjen e punimeve nga gjendja karabina e pretenduar në gjendjen përfundimtare të banueshme, rezulton se nuk është bindës deklarimi i bërë mbi blerjen e kësaj pasurie në gjendje karabina dhe në këtë kuptim mbi çmimin e paguar për blerjen e saj. Si rrjedhim, në analizën paraprake financiare është reflektuar si çmim i blerjes së kësaj pasurie, vlera sipas koston mesatare të ndërtimit për sipërfaqe shfrytëzimi për qytetin e Gjirokastrës në vitin 2003, në referim të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 8.5.2003, «Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “k”», në shumën 2,547,859 lekë.

### **Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie**

<sup>15</sup> (i) Shkresa e Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2022; (ii) Shkresa e A sh.a., me nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2022 (protokolluar në KPK me nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2022); (iii) Shpjegimet e dhëna nga subjekti mbi pyetjen nr. 6, të pyetësorit nr. 2 dhe; (iv) shkresa e “A” sh.a., me nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2022, depozituar si provë nga subjekti, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.

**24.** Siç u konstatua më sipër, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri është blerë me kontributin e familjes. Rezulton se, ndër të tjera, bashkëlidhur deklaratës “Vetting”, subjekti ka depozituar dokumentacion mbi të ardhurat nga marrëdhënia e punësimit të saj, si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tepelenë dhe Gjirokastër<sup>16</sup>, si edhe dokumentacion me qëllim provueshmërinë e qëndrimit të bashkëshortit të saj në shtetin grek dhe të ardhurat e pretenduara nga puna e kryer në emigracion<sup>17</sup>.

**24.1** E pyetur nga Komisioni se kontributin e cilës familje referon si burim krijimi të kësaj pasurie<sup>18</sup>, subjekti ka deklaruar duke konfirmuar se u referohet të ardhurave të siguruara nga paga e saj si ndihmësgjyqtare dhe gjyqtare, të ardhurave të bashkëshortit, D.M, nga emigracioni, si dhe kursimeve të tyre ndër vite, krijuar edhe para martesës.

#### **i. Të ardhurat e subjektit nga puna si ndihmësgjyqtare dhe gjyqtare**

**24.2** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting” mbi të dhënat e punësimit dhe të ardhurat e përfituara nga kjo marrëdhënie, Komisioni konstaton se:

- a) Subjekti i rivlerësimit, me vendimin e KLD-së nr. \*\*\*, datë 30.3.1995, është emëruar ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Tepelenë. Me vendimin e KLD-së nr. \*\*\*, datë 29.07.1998, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjirokastër<sup>19</sup>.
- b) Referuar vërtetimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, të datës 18.10.2016, konfirmohet se subjekti ka punuar si ndihmësgjyqtare efektive pranë Gjykatës së Rrethit Tepelenë, për periudhën prill 1995 deri më 31.07.1998. Por, për këtë periudhë arkivi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër nuk disponon dokumentacion mbi nxjerrjen e të dhënave për të ardhurat e realizuara. Po nëpërmjet këtij vërtetimi referohet se në vitin 1997 ish- godina e Gjykatës Tepelenë është djegur<sup>20</sup>.
- c) Të ardhurat neto të përfituara nga subjekti i rivlerësimit, nga puna e saj si ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Tepelenë, janë reflektuar sipas dokumentit të DRSSH-së Gjirokastër, “Vërtetim për bazën e vlerësueshme”<sup>21</sup>. Referuar këtij vërtetimi, Komisioni konstaton se mungojnë listëpagesat për periudhën shtator – dhjetor 1995 dhe për vitin 1997. Në mungesë të listëpagesave dhe si rrjedhim, të ardhurave neto të përfituara, në analizën paraprake financiare nuk janë reflektuar të ardhura për periudhën shtator – dhjetor 1995 dhe për vitin 1997.
- d) Të ardhurat neto të përfituara nga subjekti i rivlerësimit, nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, janë pasqyruar në vërtetimin e datës 18.10.2016<sup>22</sup>. Komisioni përllogariti të ardhurat neto të përfituara nga subjekti i rivlerësimit deri në datën 1.8.2003, data e blerjes së pasurisë objekt vlerësimi.

#### **ii. Të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga personi i lidhur nga puna në emigracion**

**24.3** Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga puna në emigracion gjatë viteve 1992 – 2006, në total në shumën 29,000 euro.

**24.4** Ndërsa, pas verifikimit të deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, Komisioni konstaton se:

<sup>16</sup> Dokumentacion i ndodhur në aneksin \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>17</sup> Dokumentacion i ndodhur në aneksin \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>18</sup> Pyetësori nr. 2, i dërguar nga Komisioni.

<sup>19</sup> Vërtetimi i Drejtorisë së Organizimit Gjyqësor pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2003, ndodhur në aneksin \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>20</sup> Vërtetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2016, ndodhur në aneksin \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>21</sup> Dokument i ndodhur në aneksin \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>22</sup> Vërtetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër me nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2016, ndodhur në aneksin \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së.

- a) në deklaratën fillestare të pasurisë (e vitit 2003), subjekti nuk ka deklaruar të ardhura me burim nga puna e bashkëshortit në emigracion, por rezulton se ka deklaruar si pasuri të luajtshme me regjistrim publik, automjetin e markës “\*\*\*\*”, me targë \*\*\*, me vlerë 0.75 milionë lekë (750,000 lekë), me burim krijimi kursimet personale;
- b) në DIP/2004, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ardhura me burim nga puna e bashkëshortit në emigracion;
- c) në DIP/2005, në seksionin “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari private dhe/ose publike”, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar *të ardhura për vitin 2005 nga emigracioni, Banka e Tiranës, shuma 4, 000 euro*;
- d) në DIP/2006, në seksionin “Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari private dhe/ose publike”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar *të ardhura të krijuara nga veprimtaria private e bashkëshortit, D.M, si \*\*\* në objektin Spitali i Qytetit (Sarandë), Delvinë, depozituar në “Raiffeisen Bank”, vlerën 230,000 lekë; pagën mujore e bashkëshortit, D.M, të krijuar nga emigracioni në shtetin grek dhe veprimtaria private e pjesësi si h, në vlerën 2,500 euro/në muaj; të ardhura dhe kursime bankare të bashkëshortit, D.M, nga aktiviteti i tij privat dhe emigracioni, “Tirana Bank”, vlera 8,000 euro dhe “Banka Amerikane”, vlera 1,000,000 lekë.*

**24.5** Komisioni konstaton se, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur kanë deklaruar likuiditete në rubrikën e deklarimit të të ardhurave, ato kanë referuar vendndodhjen e tyre në bankë. Por, nga verifikimi i kryer rezulton se nuk përputhen vlerat e deklaruara për vitin 2005 dhe 2006, të depozituara në bankë nga bashkëshorti i subjektit për këto vite, me gjendjen e llogarive në fund të vitit, kjo pasi gjendja e llogarive paraqitet në vlerë më të lartë. Gjithsesi, analiza e vlerave monetare gjendje në llogaritë e personit të lidhur në sistemin bankar për këto vite pasqyrohet në vijim në këtë vendim.

**24.6** Gjithashtu, nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit për vitet 2003 – 2006, nuk del qartë shuma e të ardhurave të pretenduara dhe atyre të kursyera, me burim punën e bashkëshortit në emigracion, duke theksuar se për analizimin e pasurisë objekt vlerësimi, merr rëndësi verifikimi i të ardhurave të realizuara përpara krijimit të saj, pra, para datës 1.8.2003.

**24.7** E pyetur nga Komisioni nëse ka pasur të ardhura financiare nga jashtë shtetit, duke i kërkuar të përcaktojë vlerën e tyre, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se<sup>23</sup> *në të kaluarën ka pasur të ardhura financiare bashkëshorti i saj si emigrant në Greqi. Konkretisht, për periudhën 1992 – 2006, bashkëshorti ka sjellë në Shqipëri (në shuma të vogla herë pas here), në total 29,000 euro. Kjo shumë përfaqëson kursimet e bashkëshortit të saj nga emigracioni.*

**24.8** Me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, si edhe me përgjigjet e pyetësorëve nr. 1 dhe nr. 2, të dërguar nga Komisioni, me qëllim provueshmërinë e qëndrimit në shtetin grek të bashkëshortit, D.M, si edhe të të ardhurave të deklaruara me burim nga puna e tij në emigracion, për periudhën 1992 – 1996, subjekti ka depozituar dokumentacion si vijon: i) kartë e regjistrimi të shtetasit të huaj nga policia greke më 23.7.1992; ii) vërtetim i lëshuar nga policia greke më 14.11.2003, për dorëzimin e dokumenteve për nxjerrjen e kartës së posaçme të identitetit dhe shtyrjeve të bëra deri më 16.11.2006; iii) kontratë qiraje e apartamentit të banimit, gjatë qëndrimit në shtetin grek, e datës 1.3.1999; iv) vërtetim për kohën e sigurimit, për punën e kryer në shtetin grek gjatë emigracionit, lëshuar nga Insituti i Sigurimeve Shoqërore, Arka Unike e të Punësuarve, Sektori i Zyrës së Ndërtimeve, \*\*\*, Greqi, i datës 18.3.2020; dhe v) vërtetim nga Kompania Konstruktore Njëanëtarëshe “\*\*\*\*”, i datës 26.1.2022.

**24.9** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, Komisioni vëren se ekzistojnë indicie dhe të dhëna të besueshme, të cilat provojnë qëndrimin dhe punën e kryer në shtetin grek, nga personi i lidhur, D.M. Nisur nga sqarimet e dhëna dhe pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar

<sup>23</sup> Pyetja nr. 5 e pyetësorit nr. 1 të dërguar nga Komisioni dhe përgjigjeve të depozituara nga subjekti.

gjatë hetimit administrativ, rezulton se subjekti ka kryer deklarin të pasaktë në deklaratën “Vetting”, pasi ka deklaruar se shuma 29,000 euro përfaqëson vlerën e të ardhurave dhe jo të kursimeve nga puna e bashkëshortit në emigracion.

**24.10** Në këtë kuptim, në vërtetimin nr. \*\*\*, datë 5.3.2020, të Insitutit të Sigurimeve Shoqërore, Sektori i Zyrës së Ndërtimeve, \*\*\*, Greqi, paraqiten të dhëna për numrin e ditëve mbi të cilat janë deklaruar dhe paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të personit të lidhur, për punën e kryer në sektorin e ndërtimit, për vitet 1994 – 1998, nga ku rezulton se për këtë periudhë ka qenë i siguruar për 143 ditë pune. Por, nga ana tjetër rezulton se nuk referohen të dhëna mbi të ardhurat neto të përfituara.

**24.11** Gjithashtu, në referim të vërtetimit të datës 26.1.2022, lëshuar nga Kompania Konstruktore Njëanëtarëshe “\*\*\*\*”, personi i lidhur, D.M, për periudhën 1999 – 2006, ka punuar në këtë kompani dhe se paga neto e përfituar prej tij e ndarë sipas periudhave përkatëse ka qenë si vijon: i) nga viti 1999 deri më 2000, paga neto ishte 350,000 dhrami në muaj; ii) nga viti 2001 deri në 2003, paga neto ishte 1,200 euro në muaj; iii) nga viti 2003 deri më 2005, paga neto ishte 1,500 euro në muaj; dhe iv) për vitin 2006, paga neto ishte 1,700 euro në muaj.

**24.12** Por, gjithsesi, rezulton se ky vërtetim është lëshuar nga një kompani private dhe jo nga autoritetet kompetente, me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor mbi provueshmërinë e punësimit, të ardhurave të realizuara dhe pagesën e detyrimeve tatimore përkatëse.

**25.** Në vijim të verifikimeve të kryera mbi pasuritë e bashkëshortit të subjektit përpara kryerjes së pagesës për blerjen e apartamentit objekt vlerësimi, Komisioni konstatoi se personi i lidhur, D.M, dispononte pasuritë si vijon: i) pasurinë e llojit “tokë truall” me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, ndodhur në Sarandë, me vlerë 144,000 lekë, përfituar në datën 15.3.1996; dhe ii) pasurinë e llojit “automjet”, i markës “\*\*\*\*”, tipi “124 D”, blerë në datën 7.12.2000, për çmimin 1,400,000 lekë<sup>24</sup>.

**26.** Komisioni konstaton se, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar – vetting, personi i lidhur ka deklaruar<sup>25</sup> **pasurinë e llojit truall me sipërfaqe 300 m2, të ndodhur në Sarandë, përfituar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Sarandë Nr. \*\*\*, datë 15.3.1996.** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pasuri<sup>26</sup> dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ<sup>27</sup>, rezulton se: **(i)** Me vendimin e Këshillit Bashkiak me nr. \*\*\*, datë 15.03.1996, personi i lidhur, D.M, është njohur si investitor i sheshit të ndërtimit blloku “\*\*\*\*”, parcela \*\*\*, me sipërfaqe truall 300 m2; **(ii)** Në datë 14.10.1996, personi i lidhur, D.M, ka nënshkruar me Seksionin e Financës pranë Këshillit të Rrethit Sarandë, kontratën pëfundimtare të shitblerjes<sup>28</sup> së truallit më sipërfaqe 300 m2, që i përgjigjet parcelës nr. \*\*\*, sipas planit rregullues të miratuar, për çmimin prej 144,000 lekë, të cilin në referim të kësaj kontrate e ka likuaduar duke bërë derdhjen bankare sipas mandat arkëtimit me nr. \*\*\*, datë 7.10.1996 (datë në të cilën rezulton se është nënshkruar prej tij me seksionin e financës, kontrata paraprake për shitblerjen e këtij truall). Në dokumentacionin e shitblerjes së kësaj pasurie është përcaktuar qëllimi i përdorimit të saj si shesh ndërtimi për shtëpi banimi; **(iii)** Referuar dokumentit, “Vërtetim nga Dokumenti Hipotekor”, lëshuar në datë 22.7.2012, nga ZVRPP e Rrethit Sarandë, në emër të personit të lidhur, DriD.M, figuron e regjistruar pasuria e llojit truall, me nr. \*\*\*, e ndodhur në Zonën Kadastrale\*\*\*\*, me sipërfaqe 300 m2, me adresë \*\*\*, Sarandë. Por, rezulton se mbi këtë pasuri është vendosur kufizimi në

<sup>24</sup> Dosja e këtij mjetei përcjellë me shkresën e DPSHTRR-së., me nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2022 (protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 22.04.2022).

<sup>25</sup> Deklarimi i pasurive të cilat disponohen veçmas nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, D.M.

<sup>26</sup> Dokumentacioni i paraqitur me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, ndodhur në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së, si edhe dokumentacioni i depozituar gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

<sup>27</sup> Shkresa e ASHK-së, Drejtoria Vendore Sarandë me nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2022 (protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 9.02.2022).

<sup>28</sup> Kontratë shitjeje me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.10.1996, redaktuar nga noteri publik, znj. E.GJ.

bazë të urdhërit të kufizimit të Regjistruesisit me nr. \*\*\*, datë 28.09.2010, pasi është blerë nga Këshilli Bashkiak.

**26.1** E pyetur nga Komisioni, për kufizimet e vendosura si edhe nëse ka patur ndërtim mbi këtë pasuri<sup>29</sup>, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka shpjeguar se, masat kufizuese janë vendosur në vitin 2008 për të gjitha pasuritë e përfituara me kontratë shitblerje nga Bashkia Sarandë, deri në rregullimin e marrëdhënieve me truallin dhe se këto masa rishikohen rast pas rasti duke iu bërë konfirmimi përkatës. Gjithashtu, ka deklaruar se nuk ka dërtim mbi këtë truall. Në mbështetje të deklaramëve të saj, subjekti i rivlerësimit ka depozituar: (i) shkresën “kthim përgjigje” të ASHK – Drejtoria Vendore Sarandë, me nr. \*\*\* prot., datë 02.02.2022; dhe (ii) Dokumentin, “Akt Eskpertimi”, i ekspertit topograf në projektim, z. R.B, i datës 27.01.2022, shoqëruar me fotografi.

**26.2** Pas verifikimit dhe analizimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit si dhe dokumentacionit të administruar në fuksion të hetimit administrativ të kryer lidhur me këtë pasuri, Komisioni arrin në përfundimin se nuk duket të jetë kryer ndërtim mbi pasurinë e llojit truall, të ndodhur në Sarandë, të regjistruar në emër të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, D.M.

**26.3** Në vijim, Komisioni ka konstuar se kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur në deklaratën fillestare të pasurisë (e vitit 2003) dhe as në deklaratat e interesave privatë të viteve 2004 – 2010. Por, rezulton se në DIP/2011, në deklaratën e bërë nga bashkëshorti i subjektit, në cilësinë e personit të lidhur që mbart detyrimin për deklarimin e pasurive, në seksionin “Deklarimi i interesave privatë, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme”, ndër të tjera, ka deklaruar se disponon si pasuri veçmas, një sipërfaqe trualli prej 300 m<sup>2</sup>, të ndodhur në qytetin e Sarandës, përfitur me vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë, me nr. \*\*\*, datë 15.3.1996, me kontratë shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.10.1996, hipotekuar më 13.11.1996, me vlerë 144,000 lekë.

**26.4** Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se ka dhënë shpjegime të plota për mungesën e deklaramit të kësaj pasurie, në thelb çështje harrese, duke shtuar argumentin se me të gjitha procedurat e përfitimit të pasurisë janë ndjekur nga babai i bashkëshortit, i cili gjithashtu i ka pasur në ruajtje këto dokumente. Më vonë bashkëshorti i saj, ka kryer aplikimin për lëshimin e vërtetimit hipotekor, i cili është depozituar në ILDKPKI.

**26.5** Në analizë të rrethanave dhe fakteve të mësipërme, si edhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, Komisioni vëren se në deklaratën “Vetting”, subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie dhe mbi mënyrën e fitimit të saj. Për më tepër, rezulton se kjo pasuri është fituar nga personi i lidhur disa vite para lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit, si edhe nuk u konstatuan investime të kryera mbi të gjatë viteve në vazhdim.

**26.6** Për sa më sipër, në kushtet kur nuk ka dyshime mbi mënyrën e fitimit dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues çmon se mosdeklarimi i kësaj pasurie për vitet 2003 – 2011, përbën pasktësi në deklaram me peshë specifike të tillë që nuk ndikon në vendimmarrjen përfundimtare të Komisionit.

**27.** Sikurse u konstatua më sipër, rezulton se në deklaratën fillestare të pasurisë, të vitit 2003, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, D.M, ka deklaruar pasurinë e llojit “automjet”, me targë \*\*\* me vlerë 0.75/milionë lekë (750,000 lekë), me burim krijimi kursimet personale.

**27.1** Rezulton se në DIP/2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.12.2007, bashkëshorti, D.M, ka shitur autoveturën tip “\*\*\*”, për vlerën 250,000 lekë”.

---

<sup>29</sup> Pyetja nr. 22, e Pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni.

**27.2** Pas verifikimit të dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR -ja rezultoi se, më 7.12.2000, ky automjet është blerë<sup>30</sup> nga bashkëshorti i subjektit për çmimin 1,400,000 lekë dhe se është shitur prej tij në vitin 2007.

**27.3** Komisioni konstaton se subjekti i rilerësimit/personi i lidhur në deklaratën fillestare të pasurisë ka kryer deklaram të pasaktë sa i përket vlerës së këtij automjeti.

**28.** Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit bankar, Komisioni konstatoi se z. D.M, në datën 31.12.2002, ka pasur gjendje në llogaritë e tij bankare në “Tirana Bank”<sup>31</sup> si vijon: (i) depozitë në shumën 400,000 lekë; dhe (ii) depozitë në shumën 2,500 euro. Në vijim të verifikimit të këtyre llogarive rezultoi se personi i lidhur ka tërhequr plotësisht vlerat e këtyre depozitave së bashku me interesat e përfutur përpara blerjes së pasurisë objekt vlerësimit, apartamentit në Gjirokastrë, e konkretisht: (a) në datën 2.4.2003 ka tërhequr shumën 406,627 lekë; dhe (b) në datën 7.5.2003, ka tërhequr shumën 2,500 euro.

**28.1** Komisioni konstaton se, krijimi i këtyre depozitave përkon me periudhën e martesës ligjore të subjektit me personin e lidhur<sup>32</sup> dhe, për rrjedhojë nuk përjashtohet mundësia e krijimit të tyre edhe me kontribut nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit.

**29.** Pra, rezultoi se përpara blerjes së pasurisë objekt vlerësimi – personi i lidhur dispononte veçmas dy pasuri, (i) pasurinë e llojit truall të ndodhur në Sarandë dhe (ii) pasurinë e llojit automjet \*\*\*, me vlerë totale 1,544,000 lekë.

**29.1** Por, në kushtet kur rezultoi e provuar se këto dy pasuri janë krijuar nga personi i lidhur përpara lidhjes së martesës, në dukje me të ardhurat e tij nga puna në emigracion, trupi gjykues vlerësoi të mos marrë në analizë ligjshmërinë e burimeve financiare, të cilat kanë shërbyer për krijimin e tyre dhe, në këtë kontekst, ato nuk janë përfshirë në analizën e treguesve financiarë të kryer për verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit në Gjirokastrë, të blerë në datë 1.8.2003.

**29.2** Në këtë këndvështrim, për kryerjen e një analize sa më pranë të vërtetës edhe sa u përket përlllogaritjeve të shpenzimeve jetike për periudhën deri para blerjes së apartamentit në Gjirokastrë, Komisioni vlerësoi të mos përfshijë në analizën financiare shpenzime jetike për bashkëshortin e subjektit për periudhën deri në datën e lidhjes së martesës, duke çmuar se ato janë mbuluar me të ardhurat e tij, të pretenduara si të përfutuara nga puna në emigracion.

**29.3** Në analizë të dokumentacionit të administruar lidhur me të ardhurat e pretenduara nga emigracioni, konstatimit të dy pasurive veçmas të krijuara nga personi i lidhur para martesë si edhe duke marrë në konsideratë faktin e mosreflektimit të shpenzimeve jetike të personit të lidhur para martesë, në analizën financiare paraprake Komisioni nuk reflektoi vlerë të ardhurash me burim punën në emigracion të personit të lidhur, për periudhën deri para blerjes së apartamentit në Gjirokastrë.

**30.** Sa më sipër, bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit të kryer, si edhe pas vlerësimit paraprak të bërë mbi vlerën e blerjes së apartamentit, të ardhurat e realizuara / përfutuara para blerjes së tij, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë për periudhën prej vitit 1995 – 1.8.2003, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare për kryerjen e pagesës prej 2,547,859 lekësh për likuidimin e çmimit të kësaj pasurie, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e apartamentit në datën 1.8.2003, duke rezultuar me balancë negative fondesh rreth 1.3 milionë lekë.

<sup>30</sup> Kontratë shitjeje automjeti me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.12.2000, redaktuar nga noteri publik, znj. E.GJ.

<sup>31</sup> Shkresa e “Tirana Bank” me nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2020, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2020.

<sup>32</sup> Referuar certifikatës së martesës, martesë është lidhur më 1.11.2001.

**31.** Subjektit iu kalua barra e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë argumentet/shpjegimet përfundimtare dhe të depozitonte prova të reja të mundshme mbi konstatimet e mësipërme, në funksion të provueshmërisë së vërtetësisë së deklarimeve të bëra dhe ligjshmërisë së të ardhurave, të cilët kanë shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**32.** Komisioni vëren se në prapësimet e depozituara<sup>33</sup>, subjekti i ka qëndruar shpjegimeve të dhëna më parë gjatë hetimit administrativ mbi faktin e deklaruar se apartamenti në Gjirokastër është blerë në fazën karabina, duke parashtruar se shpenzimet për punimet e ndërtimit/përshtatjes së apartamentit janë kryer nga bashkëshorti dhe miqtë (shokët) e tij, nga ku këta të fundit i kanë ofruar në tërësi edhe materialet e ndërtimit dhe se, në këmbim, bashkëshorti i saj i ka shpërblyer me punën e tij. Sqaron se këto punime janë bërë gradualisht, për shkak të emigracionit të bashkëshortit dhe privatisht, jo me shoqëri ndërtimi dhe, për pasojë nuk ekzistojnë situacione punimesh. Nga ana tjetër, subjekti pranon faktin e mosdeklarimit të shpenzimeve për përfundimin e punimeve në apartament, porse mungesa e deklarimit prej saj nuk mund të çojë në deduksionin se apartamenti nuk është blerë karabina, duke argumentuar se nuk ka deklaruar shpenzime, pasi nuk është bërë asnjë shpenzim prej saj dhe bashkëshortit për përshtatjen e këtij apartamenti dhe se për më tepër, ligji i kohës nr. 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjidhurëve dhe të disa nënpunësve publikë”, nuk parashikonte deklarimin e shpenzimeve, pasi ky parashikim është bërë për herë të parë me ligjin nr. 85/2012.

**32.1** Ndërsa, sa i përket lidhjes në datën 21.10.2003, të kontratës së pajtimit me “A” sh.a., me adresë në apartamentin objekt vlerësimi, subjekti argumenton se ky fakt nuk mund të provojë se apartamenti ka qenë i përfunduar, pasi nuk ka ekzistuar dhe nuk ekziston kusht që abonimi të bëhej vetëm për shtëpi të përfunduara.

**32.2** Gjithashtu, në mbështetje të parashtrimeve të bëra, subjekti ka depozituar dokumentacionin e ndërtimit të objektit në të cilën ndodhet apartamenti i blerë prej saj dhe personit të lidhur, nga ku ndër të tjera edhe dokumentin “Proces Verbal Kolaudimi”<sup>34</sup>, i datës 17.4.2001, në dukje pjesë e dosjes së regjistrimit të këtij objekti në regjistrat hipotekor të ZVRPP Gjirokastër, në referim të të cilit kërkon të provojë se në këtë datë ka qenë e ndërtuar vetëm 72% e karabinasë, pra se në çastin e regjistrimit hipotekor as karabinaja nuk kishte përfunduar. Duke pretenduar se nuk ka asnjë regjistrim të mëpasshëm të këtij objekti, subjekti referon se në atë kohë të gjithë noterët e Gjirokastrës kanë bërë kontrata shitje të sendeve karabina.

**32.3** Në këtë kontekst, në kuadër të provave të depozituara më parë në Komision subjekti argumenton se, ashtu sikurse personat e tjerë që kanë blerë apartament në këtë objekt në vitin 2001 edhe ajo së bashku me bashkëshortin e kanë blerë të papërfundur – në gjendja karabina apartamentin e tyre. Pra, sipas subjektit – nëse pranohet fakti se në 2001, disa shtetas i kanë blerë në fazë karabina pasuritë e tyre të ndohura në të njëjtin objekt, nuk mund të dilet në konkluzionin se ajo dhe bashkëshorti e kanë blerë të përfunduar apartamentin e tyre, kjo nisur nga vlerat e përafërta të shitblerjes së pasurive.

**32.4** Me dërgimin e prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale<sup>35</sup>, të z. S.J (pala shitëse e pasurisë objekt vlerësimi), në referim të së cilës, ndër të tjera, ai deklaroi se në cilësinë e ndërtuesit, me shtetasit Blerta dhe D.M ka lidhur kontratën e shitjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.8.2003, të apartamentit “karabina”. Subjekti ka depozituar edhe disa foto – të cilat i referon se paraqesin pamje nga objekti ku ndodhet apartamenti i saj, nëpërmjet të cilave kërkon të provojë se në këtë godinë ka ende pasuri të cilat kanë mbetur në fazën “karabina”.

<sup>33</sup> Protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2022.

<sup>34</sup> Dokument i referuar edhe më parë në përgjigje të pyetësorëve, por i cili nuk ishte depozituar në Komision.

<sup>35</sup> Deklaratë noteriale me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, datë 12.9.2022, redaktuar nga noteri publik, z. V.M.

**32.5** Megjithëse, subjekti i qëndron deklarimeve të bëra mbi blerjen e kësaj pasurie në gjendjen karabina dhe mbulimit të shpenzimeve për punimet shtesë të kryera mbi këtë pasuri – me punën e bashkëshortit të saj, nga ana tjetër kundërshton aplikimin e bërë nga Komisioni mbi vlerën e kësaj pasurie – në referim të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave me nr.1, datë 08.05.2003, «*Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “k”*», duke parashtuar se nga dokumentacioni shkresor që lidhet me ndërtimin e objektit ka rezultuar e provuar se, (i) leja e ndërtimit është e vitit 1998; (ii) pronarët e truallit kanë marrë pjesën e tyre në vitin 2001; (iii) akti i kolaudimit të objektit është i vitit 2001 dhe, (vi) regjistrimi i karabinasë është i vitit 2001. Pra, bazuar në këto dokumenta subjekti argumenton se nuk mund të thuhet se pallati është ndërtuar në vitin 2003 dhe të aplikohet kosto e ndërtimit sipas EKB-së, për vitin 2003.

**32.6** Në lidhje me të ardhurat e deklaruara si burim për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtuar, duke pretenduar sa vijon:

i. Sa i përket të ardhurave të bashkëshortit të saj nga puna në emigracion – subjekti ka referuar se ka qenë në pamundësi për dokumentimin e plotë të tyre dhe pagesën e detyrimeve tatimore përkatëse, duke deklaruar se në vitin 2013 në Greqi, me ligj, punëdhënësit janë të detyruar të ruajnë dokumentacion të punëmarrësit nga 5 deri 10 vite. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se në referim të legjislacionit fiskal – në kushtet kur bashkëshorti i saj ka kryer punë të ndryshme apo shërbime si i punësuar në shoqëri ndërtimi, tatimi mbi të ardhurat mbahej nga punëdhënësi, pra se nuk ishte detyrim i bashkëshortit të saj pagesa e këtij tatimi. Subjekti shkon më tej në arsyetimin e saj, duke referuar se në interpretim parashikimeve të bëra në ligjin për procedurat tatimore në raport me nenin D/3, të Aneksit të Kushtetutës, që të njihet e ardhura e ligjshme duhet të provohet vetëm pagesa e tatimit mbi të ardhurat dhe jo e kontributeve.

Në këtë kontekst, subjekti ka parashtuar se ka depozituar edhe dokumentacion për vërtetimin e sigurimeve për periudhën 1994 – 1998, nëpërmjet të cilit konfirmohet se bashkëshorti i saj ka qenë i regjistruar si punësuar në autoritetet përkatëse të shtetit grek – për ditë të caktuara që i përkasin kësaj periudhe.

Subjekti argumenton se, për sa kohë rezulton i provuar fakti i qëndrimit dhe punësimit të bashkëshortit të saj në shtetin grek, në analizën financiare duhet të reflektohen të ardhura nga ky burim – kjo edhe në konsideratë të faktit se në atë periudhë, bazuar në të dhënat e institucioneve financiare, remitancat e emigrantëve kanë qenë në vlera të larta.

ii. Ndërsa, sa u përket të ardhurave të përfituara nga puna e saj, Komisioni vëren se në mënyrë të përmbledhur subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, sa më poshtë vijon: a) të përllogariten dhe të reflektohen në analizë financiare të ardhurat e saj nga puna e kryer për periudhën shtator – dhjetor 1995 dhe për vitin 1997, pasi në kushtet kur rezulton e provuar se ajo ka punuar për këtë periudhë dhe fakti se mungojnë listpagesat nga institucionet përkatëse, e bën të ndodhet në kushtet e nenit 32/2, të ligjit nr. 84/2016, në pamundësi objektive për të provuar të ardhurat neto të përfituara; b) për vitin 1998 nuk janë përllogarithur saktë të ardhurat totale të përfituara prej saj nga puna, pasi nuk janë reflektuar të ardhurat nga puna si gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër; c) për vitin 2001 dhe 2002 nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat nga raporti i lejes së barrë lindjes.

**32.7** Gjithashtu, subjekti ka pretenduar rillogaritjen e shpenzimeve të saj të jetesës, bazuar në përllogaritetin e bëra në vendimmarrje të mëparshme nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, si edhe mospërfshirjen në analizë të shpenzimeve jetike të bashkëshortit edhe për periudhën nga lidhja e martesës deri në datën e blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, duke pretenduar se në këtë periudhë ai ka qenë emigrant ekonomik në shtetin grek dhe se shpenzimet e jetesës janë mbuluar nga të ardhurat e tij personale.

## **Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave**

**33.** Në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti mbi blerjen e pasurisë objekt vlerësimi në gjendje “karabina” dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni vëren se në kontratën e shitjes së kësaj pasurie nuk është cilësuar fakti i shitblerjes së saj në këtë gjendje. Për më tepër, Komisioni ngre dyshime të arsyeshme mbi faktin e pretenduar nga subjekti, bazuar në aktkolaudimin e depozituar si provë, se në vitin 2001 objekti është regjistruar në gjendje “karabina”, madje se edhe vetë karabinaja ka qenë e ndërtuar 72%, kjo pasi ligji nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar (ligji në fuqi për kohën), nuk lejonte regjistrimin e ndërtimeve të reja në gjendje “karabina”. Një regjistrim i tillë është bërë i mundur vetëm pas ndryshimeve ligjore të miratuara në vitin 2007. Për më tepër, bazuar në nenet 12 e 13 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, si udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.2.2001, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, procesverbalin e kolaudimit dhe leja e shfrytëzimit të objektit janë akte që hartohen nga personat përgjegjës, pasi janë përfunduar punimet e ndërtimit.

**34.** Referuar nenit 659 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë: *“Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”*. Ndërsa në nenin 660 i Kodit Civil, parashikohet se: *“Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”*. Në këtë kuptim, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në cilësinë e palës blerëse, si edhe z. S.J, në cilësinë e palës shitëse, kanë pasur mundësi të përcaktonin në kontratë faktin e pretenduar të shitjes së sendit, apartamentit, në gjendje “karabina”.

**34.1** Në analizë dispozitave të mësipërme, provave të administruara, si dhe duke u mbështetur në parashikimin e nenit 690 të Kodit Civil, i cili përcakton: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkak të parashikuara me ligj”*, i lidhur me nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton: *“Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklaramëve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”*, trupi gjykues përfundimisht vlerësoi të pranojë si çmim të blerjes së kësaj pasurie në datën 1.8.2003, shumën prej 900,000 lekë, sipas përcaktimit të bërë në kontratë.

**35.** Nga ana tjetër, gjithsesi në përcaktimin e vlerës totale të shpenzimeve të kryera mbi këtë pasuri, trupi gjykues vlerëson se nuk duhet anashkaluar vetëdeklarimi i bërë nga subjekti se ky apartament është blerë në gjendje “karabina” dhe në këtë kontekst kryerja e investimeve dhe shpenzimeve shtesë deri në përfundimin e plotë të tij. Në këtë kuadër, Komisioni çmon se mbeten të karakterit deklarativ dhe të paprovuara pretendimet e subjektit se nuk kanë kryer asnjë shpenzim për përfundimin e ndërtimit të plotë të apartamentit, me argumentimin se ato janë mbuluar nga puna e bashkëshortit.

**36.** Gjithashtu, në kushtet kur rezultoi e provuar se rreth dy muaj pas blerjes së kësaj pasurie, bashkëshorti i subjektit ka lidhur kontratën e pajtimit me “A” sh.a., për pajisjen me numër telefoni fiks të apartamentit objekt vlerësimi, si edhe në konsideratë të faktit se në deklaratën fillestare të pasurisë ky apartament nuk është deklaruar se është blerë i papërfunduar, Komisioni në analizën financiare përfundimtare do të vlerësojë se të gjitha investimet e tjera mbi këtë pasuri janë kryer deri në datën 31.12.2003.

**37.** Trupi gjykues vëren se koncepti i shpenzimeve të deklarueshme është parashikuar për herë të parë në ligjin nr. 85/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurëve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar. Në këtë kuptim, referuar ndryshimeve ligjore të bëra në vitin 2012, “shpenzim i deklarueshëm” është tërësia monetare, e paguar për arsim, mjekim shëndetësor, pushime, aredim, si edhe shpenzime të tjera të këtij lloji, të kryera nga subjekti

deklarues. Parë në këtë këndvështrim, rezulton i bazuar pretendimi i bërë nga subjekti se nuk ka pasur detyrim për deklarimin e shpenzimeve të kryera mbi këtë pasuri.

**38.** Mbi pretendimin e bërë nga subjekti se është gabuar në përcaktimin e çmimit të kësaj pasurie sipas kostove të EKB-së për vitin 2003, duke argumentuar se ky objekt është ngritur në vitet 1998 – 2003, Komisioni vlerëson se për sa kohë është vetëdeklaruar se objekti është blerë në gjendje “karabina”, ku sipas aktit të ekspertimit të depozituar me dërgimin e prapësimeve përbën 35% të kostos totale të objektit, pra, se 65% e punimeve janë kryer në vitin 2003, si edhe në konsideratë të faktit se janë të vogla diferencat e çmimeve mesatare të ndërtimit për metër/katror për vitet 1998 – 2003, për qytetin Gjirokastrës, të përcaktuara në vendimet dhe udhëzimet e Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kostos mesatare të banesave nga EKB-ja, ky pretendim nuk do të passillte ndryshim thelbësor në përcaktimin e vlerës totale të shpenzimeve të kryera për blerjen dhe përfundimin e punimeve të realizuara mbi këtë pasuri. Për më tepër, rezulton se kostot mesatare të ndërtimit për sipërfaqe shfrytëzimi, për vitet 1998, 1999 dhe 2000, për qytetin e Gjirokastrës, në referim të vendimeve të Këshillit të Ministrave, paraqiten me vlera më të larta se ajo e vitit 2003.

**38.1** Rezulton se, në referim të vendimeve dhe udhëzimeve të Këshillit të Ministrave «Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “k”», për vitet 1998 – 2003, kostoja mesatare e çmimit të ndërtimit për sipërfaqe shfrytëzimi për metër/katror, në qytetin e Gjirokastrës, paraqitet në vlerën 32,678 lekë. Në vlerësim të situatës hipotetike se deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes ishin kryer vetëm 35% e punimeve mbi këtë apartament, kostoja mesatare për kryerjen e këtij volumi të punimeve paraqitet në vlerën 1,005,682 lekë<sup>36</sup>, pra, pak më e lartë nga shuma e paguar nga subjekti. Ndërsa, nëse do të vlerësohej i përfunduar ky apartament në vitin 2003, kostoja mesatare e ndërtimit të sipërfaqes së shfrytëzueshme paraqitet në vlerën 2,873,376 lekë<sup>37</sup>.

**38.2** Në këto rrethana, në vijim të analizimit dhe arsytimit të bërë mbi vlerën totale të mundshme të shpenzimeve të kryera mbi këtë pasuri, si edhe mbështetur në rezultatet e dërguara subjektit pas përfundimit të hetimit administrativ, trupi gjykues përfundimisht vlerësoi të reflektojë në analizën përfundimtare financiare si investime/shpenzime shtesë të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur mbi këtë pasuri, diferencën mes vlerës së përcaktuar në referim të udhëzimit të Këshillit të Ministrave me nr. 1, datë 8.5.2003, «Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “k”», me çmimin e përcaktuar në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie<sup>38</sup>.

**39.** Sa u përket të ardhurave të pretenduara nga puna e bashkëshortit nga emigracioni, Komisioni vëren se të dhëna të besueshme të punësimit të tij në këtë shtet, e për rrjedhojë i përfitimit të të ardhurave, pasqyrohen vetëm në dokumentin “Vërtetim”, i datës 18.3.2020, të lëshuar nga Insituti i Sigurimeve Shoqërore, Arka Unike e të Punësuarëve, Sektori i Zyrës së Ndërtimeve, \*\*\*, Greqi, në referim të të cilit rezulton e provuar se personi i lidhur ka qenë i regjistruar si i punësuar në sektorin e ndërtimit, duke u siguruar në total për 143 ditë kalendarike, për periudhën që i përket viteve 1994 – 1998. Në mungesë të informacionit mbi të ardhurat e realizuara nga puna e kryer për këto vite, vlera totale e tyre është përllogaritur nga Komisioni sipas minimumit

<sup>36</sup> Sipërfaqja e shfrytëzueshme e apartamentit  $87.93 \text{ m}^2 * 32,678 \text{ lekë/m}^2 = 2,873,376 \text{ lekë}$ . Vlera prej 1,005,682 lekësh përbën 35% të vlerës totale.

<sup>37</sup> Sipërfaqja e shfrytëzueshme e apartamentit  $87.93 \text{ m}^2 * 32,678 \text{ lekë/m}^2 = 2,873,376 \text{ lekë}$ .

<sup>38</sup> Vlera sipas kostos mesatare të ndërtimit për sipërfaqe shfrytëzimi për qytetin e Gjirokastrës në vitin 2003, në referim të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 8.5.2003, «Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave në tregun e lirë të banesave dhe të koeficientit “k”», në shumën prej 2,547,859 lekësh, çmimin e përcaktuar në kontratën e shitblerjes së datës 1.8.2003, në shumën 900,000 lekë = 1,647,859 lekë.

jetik të shtetit grek, në total në shumën prej 144,338 lekë<sup>39</sup>. Megjithëse, në analizën financiare paraprake, për këtë periudhë nuk janë vendosur shpenzime jetike të personit të lidhur, në vlerësim të indicieve dhe rrethanave të tjera, të cilat tregojnë mbi qëndrimin e personit të lidhur, D.M, në shtetin grek, dhe krijimin e të ardhurave të tjera të mundshme nga puna e kryer në këtë shtet, për të garantuar një qasje sa më afër së vërtetës, trupi gjykues vendosi të përfshijë vlerën e këtyre të ardhurave të përlllogaritura, si të ardhura të mundshme, të cilat mund të kenë shërbyer për krijimin e pasurisë objekt vlerësimi.

**39.1** Në vijim të arsyetimit vlen të theksohet fakti se, megjithëse subjekti në prapësimet e saj ka pretenduar kushtet e pamundësisë në sigurimin e informacionit dhe dokumentacionit justifikues ligjor për të ardhurat e bashkëshkëshortit të saj nga puna në emigracion, Komisioni nuk vëren që të jenë bërë përpjekje në këtë drejtim. Në këtë kontekst, Komisioni i qëndron konstatimit fillestar se nuk mund të përfshihen në analizën financiare të ardhurat e pretenduara sipas vërtetimit të datës 26.1.2022, lëshuar nga Kompania Konstruktore Njëanëtarëshe “\*\*\*\*”, për sa kohë në këtë rast në përputhje me nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës, nuk përmbushet detyrimi ligjor mbi provueshmërinë e punësimit, të ardhurave të realizuara dhe pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse, si edhe as nuk u provua pamundësia në sigurimin e informacionit apo dokumentacionit përkatës.

**40.** Sa u përket të ardhurave të realizuara nga subjekti i rivlerësimit për periudhën nga fillimi i punësimit të saj deri në fund të vitit 2003, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, do të kryhen ndryshime në analizën financiare përfundimtare në zërin e të ardhurave, për sa vijon:

**i.** Në kushtet kur, në përmbushje të përcaktimve të bëra në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, u provua pamundësia objektive për disponimin e informacionit dhe dokumentacionit mbi të ardhurat e përfituara nga marrëdhënia e punësimit të subjektit, për periudhën shtator – dhjetor 1995 dhe për vitin 1997, Komisioni përlllogarit në mënyrë alternative vlerën e këtyre të ardhurave, duke vlerësuar se paga mujore neto e subjektit për periudhën shtator – dhjetor 1995, është e njëjtë me pagën e dokumentuar për muajin gusht 1995 dhe se, paga mujore neto e subjektit për periudhën janar – dhjetor 1997 është e njëjtë me pagën mujore neto të muajit dhjetor 1996 dhe muajit janar 1998. Pas përlllogaritjes së kryer, në total është shtuar në rubrikën e të ardhurave shuma prej 220,000 lekësh, nga të cilat vlera 49,064 lekë i përket periudhës shtator – dhjetor 1995 dhe vlera 171,132 lekë i përket periudhën janar – dhjetor 1997.

**ii.** Komisioni ndreqi gabimin material sa u përket të ardhurave të përlllogaritura si të përfituara nga paga neto për vitin 2006, nga ku prej totalit të të ardhurave nga paga e subjektit të rivlerësimit të pasqyruara në rezultatet e hetimit administrativ në shumën 2,147,105 lekë, shuma 206,498 lekë përbënte të ardhurat neto për vitin 2006, ndërkohë që, pas rivefikimit të dokumentacionit të administruar në dosje, rezulton se të ardhurat totale neto nga paga e subjektit për vitin 2006 janë në shumën 163,708 lekë.

**iii.** Komisioni shtoi në rubrikën e të ardhurave shumën 152,150 lekë, si pjesë e të ardhurave të papërfshira në analizën paraprake financiare që përfaqësojnë të ardhurat neto nga puna e subjektit të rivlerësimit si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjyrokastër, për vitin 1998.

**40.1** Ndërsa, sa i përket pretendimit të subjektit mbi përfshirjen në analizë financiare të të ardhurave të përfituara nga raporti i lejes së barrëindjes, për vitet 2001 dhe 2002, Komisioni çmon të theksojë se këto të ardhura janë marrë në konsideratë dhe se janë pasqyruar në rresht të veçantë në tabelën e analizës financiare paraprake të dërguar me rezultatet e hetimit administrativ, pra se nuk qëndron ky pretendim i ngritur nga subjekti.

---

<sup>39</sup> Llogaritja e të ardhurave të personit të lidhur në Greqi për 143 ditë pune, sipas referencave të vitit 1994-1998, për minimumin jetik; <http://www.statistics.gr/el/statistics/-/publication/SFA10/>.

**41.** Në vijim, në vlerësim të pretendimit të subjektit mbi reduktimin e shpenzimeve vetjake jetike, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, trupi gjykues vendosi të pranojë kërkesën e bërë për rrillogaritjen e shpenzimeve jetike, duke konsideruar se për periudhën 1995 – 1999, ato përbënin 30% të të ardhurave të vitit<sup>40</sup> dhe jo në masën 66% të të ardhurave të vitit, sa ishte përllogaritur në rezultatet e hetimit administrativ.

**41.1** Gjithashtu, në mungesë të evidencave të besueshme mbi qëndrimin e bashkëshortit të subjektit në Shqipëri, për periudhën nga lidhja e martesës deri në fund të vitit 2003, u pranua pretendimi i subjektit, duke u vlerësuar të mos përfshihen në analizë financiare shpenzime jetike të personit të lidhur për këtë periudhë, pra reduktimin e shpenzimeve jetike të reflektuara në analizën financiare paraprake, duke çmuar se ato janë mbuluar me të ardhurat e tij, të pretenduara si të përfituara nga puna në emigracion.

**42.** Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit si edhe dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen e pagesës prej 900,000 lekësh në datën 1.8.2003 dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera për punimet e realizuara në përfundimin e ndërtimit të pasurisë objekt vlerësimi deri në fund të vitit 2003, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 1.**

<b>Analiza financiare për periudhën 1995 – 2003</b>	<b>Vlerat në lekë</b>
Të ardhura të subjektit të rivlerësimit	2 722 247
Të ardhurat e bashkëshortit nga emigracioni	144 338
Të ardhura të subjektit të rivlerësimit nga raport barrë lindjeje	133 489
<b>Total i të ardhurave</b>	<b>3 000 074</b>
Blerja e apartamentit në Gjirokastrë	900 000
Shpenzime të kryera për përfundimin e punimeve në apartamentin e blerë në Gjirokastrë	1 647 859
Shpenzime jetike për subjektin e rivlerësimit	728 188
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>3 276 047</b>
<b>Rezultati Financiar/balanca e fondeve</b>	<b>-275 973</b>

**42.1** Pra, rezulton se edhe sipas analizës financiare përfundimtare subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht shpenzimet e kryera për pasurinë objekt vlerësimi, apartamentin në Gjirokastrë.

**43.** Por, gjithsesi trupi gjykues mori në analizë vlerën e balancës negative të fondeve në raport me të gjitha pretendimet e ngritura nga subjekti, si edhe në shqyrtim të gjithë të dhënave dhe rrethanave të tjera të rezultuara nga hetimit administrativ i kryer dhe, në këtë kuadër, argumenton se:

- a) së pari, në kushtet kur pranohet fakti se investimet shtesë të kryera mbi këtë pasuri janë kryer në mënyrë informale, pra, jo nga subjekte të licencuara dhe të regjistruara në organin tatimor, në përllogaritjen e kostos mesatare të ndërtimit do të zbriteshin vlera të cilat kanë të bëjnë me zëra shpenzimesh shtesë që u takojnë shoqërive të ndërtimit, kryesisht në aspektin fiskal;
- b) së dyti, nga hetimi administrativ i kryer, Komisioni krijoi bindjen se bashkëshorti i subjektit ka punuar në vazhdimësi në sektorin e ndërtimit dhe në këtë këndvështrim rezulton i pranueshëm fakti i deklaruar se një pjesë e punimeve mund të jenë kryer me kontributin – punën e tij;

<sup>40</sup> Referuar vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. \*\*\* (JR).

- c) së treti, pavarësisht se Komisioni për efekt të analizës financiare të kryer vlerësoi se punimet shtesë janë mbyllur deri në fund të vitit 2003, nuk përjashtohet mundësia që disa punime mund të jenë kryer edhe gjatë vitit 2003 e në vijim.
- d) Së katërti, Komisioni çmon të theksojë se janë vlerësuar në minimumin jetik të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga puna në emigracion për ditët e konfirmuara të sigurimit.

**44.** Si përfundim, në vijim dhe në përputhje me arsyetimin e mësipërm, në lidhje rezultatin e analizës financiare, trupi gjykues çmon se balanca negative e konstatuar në vlerësimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurisë objekt vlerësimi, në total në shumën rreth 276,000 lekë, nuk është e mjaftueshme që të passjelli aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analizë kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

**45. Pasuria e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 73 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tepelenë,** me vlerë 21,351 lekë, përfituar nga ligji i privatizimit (1/4 pjesë) dhe pjesa tjetër me trashëgimi ligjore (1/20 pjesë). Subjekti ka deklaruar se zotëron 30% pjesë takuese të kësaj pasurie.

**45.1** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar lidhur me këtë pasuri<sup>41</sup> konfirmohet se ky apartament është përfituar nga anëtarët e familjes Çibuku (mbiemri i subjektit para martesë) sipas ligjit të privatizimit<sup>42</sup>, duke lidhur në datën 18.6.1993, kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie me NKB, nga ku subjekti i rivlerësimit zotëronte ¼ pjesë takuese. Gjithashtu rezultoi se, me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, në datën 15.9.2014 është bërë lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore<sup>43</sup> për trashëgimlënësin B.Ç (i ndjeri, babai i subjektit), duke u përcaktuar subjekti si trashëgimtare ligjore e rradhës së parë me 1/5 pjesë mbi të drejtat dhe detyrimet trashëgimore.

**45.2** Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri dhe pjesën takuese mbi të në deklaratën fillestare të psurisë dhe në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë vijues deri në DIP/2016.

**46.** Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratat e viteve 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se *nisur nga fakti i mungesës së kontributit të saj në kohën e blerjes së apartamentit në vitin 1993, ka vlerësuar se nuk duhet ta deklaronte, duke pasur dhe bindjen se është pasuri e prindërve. Çelja e dëshmisë së trashëgimisë ligjore është bërë vetëm me qëllimin për të tërhequr depozitën bankare të babait. Subjekti shpjegoi gjithashtu se fakti që dëshmia e trashëgimisë nuk është depozituar në ZVRPP-në Tepelenë tregon qartë se nuk dëshiron ta përvetësojë atë.*

**47.** Në analizë të rrethanave dhe fakteve të mësipërme, si edhe nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, Komisioni vëren se në deklaratën “Vetting”, personi i lidhur kanë deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie dhe mbi mënyrën e fitimit të saj. Për më tepër, rezultoi se kjo pasuri, pjesa takuese mbi të, është fituar me ligjin e privatizimit dhe nëpërmjet trashëgimisë ligjore.

**47.1** Për sa më sipër, në kushtet kur nuk ka dyshime mbi mënyrën e fitimit dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues çmon se mosdeklarimi i kësaj pasurie për vitet 2003 – 2016, përbën pasaktësi në deklarim me peshë specifike të tillë që nuk ndikon në vendimmarrjen përfundimtare të Komisionit.

<sup>41</sup> Dokumentacion i ndodhur në aneksin \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>42</sup> Ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

<sup>43</sup> Dëshmi trashëgimie ligjore me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.9.2014, redaktuar nga noteri publik, z. R.S.

**48. Pasuritë e llojit “likuiditete” të materializuara në katër llogari bankare** në disa banka të nivelit të dytë, në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, me gjendje në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, si vijon:

i. Gjendja e llogarisë së subjektit në “Societe Generale Bank”, në vlerën prej 1,154,378 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga paga;

ii. Gjendja e llogarisë “depozitë kursimi për fëmijë”, në emër të djalit, A.M, në vlerën 692,919 lekë, me burim krijimi kursimet nga pagat, dhurata të vogla nga të afërmit, si dhe interesat bankarë;

iii. Gjendja e llogarisë “depozitë kursimi për fëmijë”, në emër të djalit, K.M, në vlerën 692,919 lekë, me burim krijimi kursimet nga pagat, dhurata të vogla nga të afërmit, si dhe interesat bankarë;

iv. Zotëron  $\frac{1}{4}$  (25%) pjesë takuese të gjendjes së llogarisë rrjedhëse në emër të babait, B.Ç, bazuar në dëshminë e trashëgimisë ligjore me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.09.2014.

**48.1** Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit administrativ konfirmohen gjendjet e deklaruara të llogarive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”.

### **Pasuri të tjera, të deklaruara veçmas nga personi i lidhur, D.M**

**49. Pasuria e llojit “automjet”, i markës “\*\*\*\*”<sup>44</sup>**, tip “E200”, me targë \*\*\*, me vlerë 250,000 lekë, me burim krijimi të ardhurat e përfituara nga shitja në datën 14.12.2007 të automjetit me targë \*\*\*.

**49.1** Komisioni konstaton se në DIP/2007 subjekti ka deklaruar: “*Me kontratë me nr. \*\*\* Rep, nr.\*\*\* kol., datë 04.12.2007, bashkëshorti, D.M, ka shitur automjetin tip “Benz” në vlerën 250,000 lekë. Me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.12.2007, ka blerë një automjet tip “Benz” në vlerën 250,000 lekë*”. Ndërsa personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, në DIP/ 2007 ka deklaruar se: “*...ka ndryshuar automjetin tip “Benz” me të njëjtin tip dhe çmim të pandryshuar sipas kontratës së shitblerjes bashkëngjitur deklaratës. U shit 250,000 lekë, u ble 250,000 lekë*”.

**50.** Nga verifikimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së<sup>45</sup> konfirmohet se më 12.12.2007, z. D.M ka blerë këtë pasuri<sup>46</sup> për çmimin 250,000 lekë. Gjithashtu, sikurse u konstatua më sipër, konfirmohet se në datën 4.12.2007, personi i lidhur e ka shitur<sup>47</sup> automjetin e markës “\*\*\*\*”, të cilin e kishte blerë më parë në datën 7.12.2000, për vlerën 1,400,000 lekë.

**50.1** Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti/personi i lidhur ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

**51. Pasuria e llojit automjet, i markës “\*\*\*\*”,** me targa \*\*\*, me vlerë 2,000 euro, me burim krijimi të ardhurat prej kursimeve nga puna.

**51.1** Komisioni konstaton se kjo pasuri është deklaruar edhe në DIP/2006, si vijon: “*Autoveturë \*\*\* viti i prodhimit 1998. Blerë nga kursimet e të ardhurat me targë \*\*\*. Vlera 2,000 euro*”.

<sup>44</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneksi \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së) kopje të dokumenteve: kontratë shitblerjeje automjeti me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.12.2007; certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor, për automjetin me targë \*\*\*; leje qarkullimi, për automjetin me targë \*\*\*, targa e mëparshme e automjetit objekt vlerësimi; dhe kontratë shitjeje mjete nr. \*\*\* rep, nr.\*\*\* kol., datë 4.12.2007.

<sup>45</sup> Shkresa e DPSHTRR-së, me nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2020, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 15.12.2020.

<sup>46</sup> Kontratë shitblerjeje automjeti, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.12.2007, redaktuar nga noteri publik, z. I.H.

<sup>47</sup> Kontratë shitjeje automjeti me nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 04.12.2007.

**52.** Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-së, për këtë automjet, konfirmohet se në datën 14.8.2006, personi i lidhur, z. D.M, ka blerë<sup>48</sup> këtë pasuri për çmimin 250,000 lekë.

**53.** Komisioni kreu analizën financiare paraprake, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për blerjen e kësaj pasurie në datën 14.8.2006, nga ku u konstatua se ata nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e çmimit për blerjen e këtij automjeti, duke rezultuar me balancë negative fondesh në vlerën - 438 mijë lekë.

**54.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet përfundimtare dhe të depozitonte prova të reja të mundshme mbi konstatimin e mësipërm, në funksion të provueshmërisë së ligjshmërisë të burimit të të ardhurave, të cilët kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

**55.** Me dërgimin e prapësimeve, subjekti ka kundërshtuar rezultatet e analizës financiare, duke pretenduar të reflektohen të ardhura me burim punën në emigracion të bashkëshortit të saj, përgjatë vitit 2006, si edhe ripërlllogaritjen e shpenzimeve jetike, duke pretenduar se bashkëshorti i saj për këtë periudhë ka jetuar në shtetin grek.

**56.** Pasi vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti i saj nga puna në emigracion, si edhe provat shkresore të administruara në këtë kuadër, Komisioni vëren se nuk është depozituar dokumentacion justifikues për të provuar ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

**57.** Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2006 – 14.08.2006, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 2.**

<i>Analiza financiare për verifikimin e mundësisë së blerjes së automjetit “***” Periudha e analizës 1.1.2006 - 14.8.2006</i>	<i>Vlerat në lekë</i>
Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga data 1.1.2006 -14.8.2006	420 740
Të ardhura nga interesat bankarë	67 620
Shpenzimet jetike	255 633
Vlera e blerjes së automjetit të markës “***”	247 406
Shtesat në likuiditetet në sistemin bankar për periudhën e analizës	351 285
Shpenzime për udhëtim	7 916
Shpenzime për mobilim	64 167
<b>Rezultati financiar</b>	<b>- 438 047 lekë</b>

**57.1** Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar krijimin në datën 14.8.2006, të pasurisë së llojit “automjet”, automjet, të markës “\*\*\*”, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

**58. Pasuri e llojit “likuiditet”, gjendje e llogarisë rrjedhëse në BKT, në vlerën 43,635 lekë,** me burim krijimi të ardhurat nga aktiviteti si \*\*\*.

<sup>48</sup> Kontratë shitblerjeje automjeti, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.08.2006, redaktuar nga noteri publik, z. I.H.

**58.1** Nga verifikimi dhe analizimi i informacionit/dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit administrativ<sup>49</sup>, rezulton se kjo llogari është hapur nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, në datën 12.9.2011, dhe se gjithashtu konfirmohet gjendja e deklaruar e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”. Referuar lëvizjeve të kësaj llogarie, Komisioni konstatoi se, ndër të tjera, në të janë depozituar cash disa vlera monetare, nga shtetas të ndryshëm, disa prej të cilave kanë përshkrimin “...për punime \*\*\*”.

**58.2** Nisur nga fakti se kjo llogari është deklaruar me burim të ardhurat e personit të lidhur me burim nga aktiviteti i tij si \*\*\* në Shqipëri, Komisioni u ndal në analizimin e deklarimeve të bëra mbi këto të ardhura të pretenduara, si edhe dokumentacionin justifikues ligjor për të provuar krijimin e tyre.

**58.3** Komisioni vëren se, megjithëse subjekti i rivlerësimit dhe/apo bashkëshorti në deklaratat e interesave privatë të viteve 2006 – 2011, kanë deklaruar në vijimësi të ardhura me burim nga aktiviteti i personit të lidhur si \*\*\* në Shqipëri, rezulton se nuk kanë depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar krijimin e këtyre të ardhurave.

**59.** Pasi Komisioni me dërgimin e rezultateve të hetimit i kaloi barrën e provës mbi analizën financiare paraprake të kryer, në referim të së cilës nuk janë reflektuar të ardhura me burim nga puna e personit të lidhur si \*\*\* në Shqipëri, subjekti ka parashtruar se bashkëshorti i saj ka ushtruar zanatin e \*\*\* dhe ka kryer punime si për individë, ashtu edhe për shoqëri ndërtimi, në qytete të ndryshme, pavarësisht se nuk ka qenë i pajisur me NIPT (sikundër asnjë zanaççi për këtë periudhë). Gjithashtu, subjekti ka pohuar se, me cilësinë e gjyqtarës, nuk mund të justifikojë mungesën e regjistrimit tatimor të bashkëshortit, por tregu i punës sezonal është shumë i ashpër në qytete të vogla dhe mbajtja e një vetëpunësimi përgjatë gjithë vitit, për tre muaj punë në vit, është e pamundur.

**60.** Në vlerësim të shpjegimeve të dhëna, si edhe dokumentacionit të administruar në dosje, si edhe atij të depozituar nga subjekti në këtë kuadër, Komisioni vëren se ekzistojnë të dhëna/indicie që tregojnë se bashkëshorti i subjektit mund të ketë punuar në sektorin e ndërtimit, kryesisht si \*\*\*. Por, Komisioni konstaton se në përmbushje të detyrimit ligjor të parashikuar në nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e realizuara nga ky aktivitet.

**61. Pasuria e llojit “likuiditet”, depozitë bankare në BKT, në shumën 21,307 euro,** krijuar nga kursimet e akumuluar, nga babai i bashkëshortes pas vdekjes dhe nga interesat bankarë.

**61.1** Si burim krijimi të kësaj pasurie personi i lidhur ka deklaruar: “Nga kursimet e akumuluar, nga babai i bashkëshortes pas vdekjes dhe nga interesat bankarë”. Ndërsa, subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar në seksionin “Angazhime dhe veprimtari private dhe / ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre” ka deklaruar: “Të ardhura të lëna në ruajtje nga babai, para cash shuma 10,000 euro”.

**61.2** Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës “Vetting” disa dokumente në lidhje me të ardhurat 10,000 euro të pretenduara si “të lëna në ruajtje”, që lidhen me punësimin, qëndrimin dhe të ardhurat e krijuara nga ana e motrave të subjektit M.M dhe L.GJ, si dhe dokumentacion për ardhurat nga pensionet e prindërve<sup>50</sup>.

<sup>49</sup> Shkresa e BKT-së me nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2020, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2020.

<sup>50</sup> Dokumentacion i ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së, aneksi \*\*\*; vërtetim nr. \*\*\*prot., datë 23.1.2017, nga BKT, ku vërtetohet se D.M ka depozitë me gjendje 21,307 euro; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.8.2017, nga BKT, e cila konfirmon llogari në emër të D.M me gjendje në datën 27.1.2017, në vlerën 21,307 euro; dokumentacion për të ardhurat e siguruara nga emigracioni të bashkëshortit të motrës L.GJ (leje qëndrimi, vërtetim sigurimesh shoqërore dhe çeqe të ardhur); dokumentacion të të ardhurave që ka siguruar bashkëshorti i motrës M.M gjatë viteve të emigracionit, si edhe leje qëndrimi, vërtetim i sigurimeve shoqërore, deklarata për të ardhurat vjetore nga viti 2000,2003,2004,2006-2013; certifikatë vdekjeje e babait B.Ç, i cili ka ndërruar jetë në datën 1.2.2010; vërtetim i DRSSH-së Gjirokastër, ku vërtetohet se B.Ç, ka pasur të ardhura nga pensioni për periudhën nga viti 1993 – 2001,

**61.3 Deklarimi i kësaj pasurie në vite:** nga verifikimi i deklarave të interesave privatë/periodikë vjetorë, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në vite në ILDKPKI konstatohet se: i) në DIP/2010, subjekti ka deklaruar: “*Të ardhura “cash” nga babai im pas vdekjes 10 000 euro*”; ii) në DIP/2011, personi i lidhur ka deklaruar: “*Depozitë kursimi në BKT hapur në datën 13.3.2011. Vlera 20,000 euro, burimi të ardhurave cash nga babai i bashkëshortes pas vdekjes dhe kursimet gjendje në shtëpi deklaruar deri në 31.12.2010*”; iii) në DIP/2013, personi i lidhur ka deklaruar: “*Të ardhura nga interesat bankare mbi shumën e depozituar pranë BKT, dega Gjirokastrë për periudhën 1.1.2013-31.12.2013, shuma 370 euro*”; iv) në DIP/2015, subjekti ka deklaruar: “*Në numrin e llogarisë bankare pranë BKT, në emër të bashkëshortit D.M (e deklaruar si shumë) janë përfutur interesat bankare në shumën 89 euro dhe është mbajtur tatim në burim 10%,*”; dhe v) në DIP/2016, personi i lidhur ka deklaruar: “*llogari depozitë pranë BKT (shtim) burimi i krijimit interesat bankare shuma 27 euro*”.

**61.4 Konkluzioni i ILDKPKI-së që lidhet me këtë pasuri:** “*Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e shtetasit B.Ç, të cilat kanë shërbyer si burim krijimin e depozitës në shumën prej 20,000 eurosh, në vitin 2010; deklarim i pasaktë lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për depozitën e hapur në vitin 2010, në shumën 20, 000 euro, pasi në deklaratën e pasurive “Vetting” ka deklaruar si burim kursimet e babait të subjektit, kurse në DIP/2011 janë deklaruar edhe kursimet familjare ndër vite*”.

#### **Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni për këtë pasuri**

**62.** Nga verifikimi dhe shqyrtimi i informacionit/dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit administrativ<sup>51</sup> për llogaritë e personit të lidhur, rezulton se: i) në datën 11.3.2011, personi i lidhur ka depozituar *cash* në BKT vlerën 20,000 euro, duke e kaluar këtë shumë në depozitë me afat 6-mujor; ii) në datën 2.4.2012, shuma e depozitës së bashku me interesat e përfutur ka qenë në vlerën 20,543 euro, e cila më pas është investuar në depozitë me afat 5- vjeçar dhe rezulton se është maturuar në datën 29.5.2017, në vlerën 21,316 euro.

#### **Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie**

**63.** Siç u konstatua edhe më sipër, në DIP/2011 subjekti ka deklaruar krijimin e kësaj depozite me burim krijimi i) burimi i të ardhurave *cash*, kursimet nga babai i bashkëshortes pas vdekjes dhe ii) kursimet gjendje në shtëpi, deklaruar deri në datën 31.12.2010.

##### *a. Verifikimi i të ardhurave të deklaruara me burim kursimet nga babai i subjektit*

**63.1** Në referim të pikës 14 të nenit 3 dhe nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson se babai i subjektit të rivlerësimit kategorizohet në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për justifikimin e pasurisë, e në këtë rast bazuar në parimin e proporcionalitetit justifikimin e ligjshmërisë së burimeve financiare, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 10,000 euro, deklaruar si një nga burimet e pasurisë objekt vlerësimi.

**63.2** ISSH-ja<sup>52</sup> informon Komisionin se shtetasja B.Ç, ka përfutur pension pleqërie prej muajit tetor 1993 me masë mujore aktuale 18,255 lekë në muaj. Ndërsa sipas dokumentacionit të përcjellë nga subjekti me deklaratën “Vetting”<sup>53</sup> babai i subjektit të rivlerësimit, z. B.Ç ka përfutur pension pleqërie prej datës 1.4.1993 - 31.12.2011 me vlerë totale 546, 936 lekë dhe nëna e subjektit ka përfutur vlerën totale 421, 127 lekë.

---

në vlerën totale 421,127 lekë; vërtetim i DRSSH-së Gjirokastrë, ku vërtetohet se B.Ç, ka pasur të ardhura nga pensioni për periudhën 1992-2001 në vlerën totale 546,936 lekë.

<sup>51</sup> Shkresa e BKT-së me nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2020, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2020;

<sup>52</sup> Shkresa e ISSH-së., me nr.\*\*\* prot., datë 9.12.2020, protokolluar në Komision me nr.\*\*\* prot., datë 11.12.2020.

<sup>53</sup> Vërtetim i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastrë; aneksi \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

**63.3** E pyetur gjatë hetimit administrativ nga Komisioni<sup>54</sup> nëse kishte autorizim për përdorimin e pasurive/llogarive bankare në emrin e ndonjë personi tjetër në Shqipëri apo jashtë shtetit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, në llogarinë e hapur nga bashkëshorti, D.M, në BKT, Dega Gjirokastrë, në vitin 2011, është depozituar edhe shuma 10,000 euro. Kjo shumë është lënë nga i ati B.Ç disa ditë para vdekjes, të cilat janë nga kursimet e tij dhe nga të hollat e dërguara nga dy vajzat e tjera që jetojnë në emigracion L.GJ dhe M.M. Në vijim ka shpjeguar se, për këtë shumë ka diskutuar me nënën mbi disponimin e kësaj shume, e cila i ka thënë se duke qenë e vetme në shtëpi nuk ndjehej e sigurtë të mbante një shumë të tillë, pasi jetonte e vetme në Tepelenë. Pra, për të mos mbajtur shuma të mëdha në banesë, subjekti deklaroi se vendosi të depozitonte në bankë dhe në çdo rast nevojë ti tërheqi.

**63.4** Sa më sipër, pasi Komisioni i kërkoi sqarime subjektit për të saktësuar kontributin e secilës prej motrave të saj në krijimin e shumës së pretenduar prej 10,000 euro, të disponuar më parë prej babait, subjekti ka pohuar se kontributi ka qenë i barabartë, por nuk përcaktoi vlerë dhe nuk depozitoi dokumentacion ligjor provues.

**63.5** Në mbështetje të deklarimeve të saj, subjekti depozitoi dokumentacionin mbi qëndrimin dhe punësimin e motrave të saja, L.GJ dhe M.M, si edhe dokumentacionin financiar për të ardhurat e realizuara<sup>55</sup>.

**63.6** Por, për sa kohë subjekti nuk saktësoi kontributin konkret të pasqyruar në vlerë dhe periudhën përkatëse të dërgimit të vlerave monetare nga secila prej motrave të subjektit, Komisioni paraprakisht vlerësoi se në analizën financiare të krijimit të shumës prej 10,000 euro nga personi tjetër i lidhur, babai i subjektit, nuk mund të përfshihen të ardhura me burim të ardhurat nga puna e motrave të saj në emigracion.

**63.7** Sa më sipër, në kushtet kur të vetmet të ardhura të provuara me dokumentacion ligjor, të cilat mund të kenë shërbyer si burim krijimi të shumës 10,000 euro nga babai i subjektit, janë të ardhurat e prindërve të subjektit nga pensioni i pleqërisë, rezulton se personi tjetër i lidhur (babai i subjektit) nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e shumës prej 10,000 euro, pretenduar si të “lënë në ruajtje” subjektit, e në vijim depozituar në llogarinë bankare të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit.

*b. Verifikimi i të ardhurave të deklaruara si kursime cash, gjendje në datën 31.12.2010*

**63.8** Nga verifikimi i deklarimeve të bëra mbi disponimin e likuiditeteve *cash* në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituar ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstaton se: i) në DIP/2008, subjekti ka deklaruar “*Kursime e krijuara nga të ardhurat paga mujore dhe puna private e bashkëshortit, gjendje në shtëpi 500,000 lekë*; ii) në DIP/2009 subjekti ka deklaruar “*Kursime e krijuara nga të ardhurat paga mujore, shpërblimet, orët shtesë dhe puna private e bashkëshortit, gjendje në shtëpi 600,000 lekë*; dhe iii) në DIP/2010, subjekti ka deklaruar “*Gjendja në “Cash” që janë kursimet e krijuara nga të ardhurat në “Raiffeisen Bank” deri më 31.12.2010, vlera 700,000 lekë*.”

**63.9** Në analizë të deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit rezulton se në fund të vitit 2010 gjendja e kursimeve *cash* ka qenë në shumën 700,000 lekë, kjo vlerësuar edhe në harmoni me deklaratimet e likuiditeteve të bëra në DIP/2011<sup>56</sup>.

**63.10** Nga ana tjetër, referuar analizës financiare paraprake të kryer nga Komisioni, rezulton se vitet 2008 dhe 2010 paraqiten me balancë negative fondesh (vite në të cilin subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* në shumën 500,000 lekë + 100,000 lekë).

<sup>54</sup> Pyetja nr. 7, e Pyetësor nr. 1.

<sup>55</sup> Kopje të faqeve të pasaportave dhe kartave të identitetit të L dhe L.G, M dhe A.M; kopje të deklaratimit të të ardhurave dhe shpenzime për A.M prej vitit 2000-2013; kopje të deklaratimit të ardhurave për L.GJ për vitin 2003-2004; si edhe çeqet e paguara nga puna e bashkëshortit të L.GJ shtetasit L.GJ.

<sup>56</sup> Deklarata e interesave privatë/periodike vjetorë të vitit 2011.

**63.11** Sa më sipër, konstatohet se në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar saktë të dhënat e pasurisë objekt vlerësimi, depozitës në shumën 21,307 euro, në “BKT Bank”, por gjithsesi rezulton se nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin saj.

**63.12** Nga hetimi administrativ i kryer, Komisioni konstatoi se në datën 29.9.2010, nëna e subjektit të rivlerësimit ka derdhur *cash* në llogarinë e saj në BKT<sup>57</sup>, vlerën 4,900 euro të cilat i ka mbyllur në depozitë kursimi, e cila është ende aktive. Pra, në kushtet kur rezulton se shtetasja B.Ç (nëna e subjektit) kishte aftësinë që të depozitonte, mbante dhe administronte vetë shumën prej 10,000 euro, mbetet i paqartë dhe kontradiktor deklarimi i bërë nga subjekti që nëna t'i ketë pohuar se, duke qenë e vetme në shtëpi, ndihej e sigurt të mbante një shumë të tillë.

**63.13** Gjithashtu, në kushtet kur rezulton e provuar se në datën 15.9.2014, është çelur dëshmia e trashëgimisë ligjore e të ndjerit, babait të subjektit, z. B.Ç<sup>58</sup>, Komisioni vlerëson se shuma prej 10,000 euro, do duhej t'i nënshtrohej pjesëtimit midis trashëgimtarëve ligjorë.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**64.** Komisioni vëren se, në lidhje me depozitën në vlerën 20,000 euro të krijuara nga personi i lidhur në vitin 2011, subjekti u ka qëndruar sqarimeve dhe shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, duke parashtruar se një pjesë saj, e konkretisht shuma prej 10,000 euro, e cila si pjesë përbërëse e vlerës 20,000 euro të depozituar prej personit të lidhur në vitin 2011, ka statusin e parave në ruajtje, të cilat, edhe me miratimin e motrave të saj, do të përdreshin në rast nevojë për nënën<sup>59</sup>. Kjo shumë nuk mund të konsiderohet nga Komisioni vetëm si e babait të saj, pasi ajo është krijuar gjatë regjimit martesor të bashkësisë ligjore.

**64.1** Në vijim, në prapësimet e dërguara, por edhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka argumentuar se, Komisioni legjitimohet të kryejë analizë financiare për personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur, por në këtë rast i) këto të holla nuk janë objekt i ndonjë marrëdhënieje financiare; ii) paratë nuk i janë nënshtuar pjesëtimit pasi nëna është bashkëpronare në gjysmën e kësaj pasurie dhe ato mund të përdoren për nevojat e saj; iii) paratë nuk kanë pasur ndonjë status tjetër që ta çonte Komisionin të hetonte për mundësinë financiare të prindërve, për rrjedhojë ata nuk janë persona të tjerë të lidhur, sepse ligji i lidh vetëm me kontrata të caktuara.

**64.2** Në përmbyllje të prapësimeve të subjektit për këtë çështje, subjekti ka sqaruar se në DIP/2008 ajo ka deklaruar kursime në vlerën 500,000 lekë dhe në DIP/2009 ka deklaruar kursime 600,000 lekë, duke pretenduar se këto nuk janë shuma progresive, por shtesa të ndodhura në kursimet *cash* nga viti në vit, porse gabimisht ka përdorur shprehjen “*gjendje në shtëpi*” duke iu referuar shumave të kursyera, por realisht ka dashur të deklarojë gjendjen progresive prej 1,100,000 lekësh (500,000 lekë + 600,000 lekë), shumë e cila, së bashku me disa kursime të tjera të krijuara prej saj dhe personit të lidhur nga data 1.1.2011 – 13.3.2011, kanë bërë të mundur krijimin e shumës prej 10,000 euro, si pjesë e shumës prej 20,000 euro, të depozituara në llogari nga personi i lidhur. Subjekti i rivlerësimit gjithashtu ka argumentuar se vlera 700,000 lekë në DIP/2010 është deklaruar gabimisht prej saj, pasi në fakt kjo ka qenë gjendja e llogarisë në “Raiffeisen Bank” dhe nuk lidhet me deklaratimet e gjendjes *cash* në shtëpi.

### **Analiza e provave/vlerësimi përfundimtar i Komisionit për këtë pasuri**

<sup>57</sup> Shkresa e BKT-së me nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2020, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2020.

<sup>58</sup> Dëshmia e trashëgimisë ligjore me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.9.2014.

<sup>59</sup> Në mbështetje të prapësimeve të bërë subjekti ka depozituar deklaratat e bëra nga motrat e saj: deklaratë noteriale me nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 10.9.2022, redaktuar nga noteri publik, z. V.M; deklaratë noteriale me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 19.9.2022, redaktuar nga notetri publik, z. V.M; deklaratë noteriale me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.9.2022, redaktuar nga noteri publik, z. G.B.

**65.** Pasi analizoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti, lidhur me krijimin e pasurisë në vlerën 21,300 euro, si llogari depozitë në emër të bashkëshortit të saj, Komisioni vëren se:

a. Së pari, megjithëse subjekti ka depozituar deklarata noteriale të motrave të saj mbi dhënien e vlerave monetare në favor të babait të saj të ndjerë, sërish nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor mbi ligjshmërinë e të ardhurave të pretenduara prej tyre nga puna në emigracion.

b. Së dyti, paraqiten kontradiktore dhe të palogjikshme shpjegimet e dhëna nga subjekti mbi lënien e kësaj shume në ruajtje, kjo për shkak se rezultoi e provuar se nëna e saj kishte hapur llogari depozitë në valutën euro, vetëm rreth gjashtë muaj para depozitimit të shumës 20,000 euro në llogarinë e personit të lidhur dhe, për më tepër, pas rreth shtatë muajsh mbasi kishte ndërruar jetë bashkëshorti i saj, i ndjeri B.Ç.

c. Së treti, megjithëse subjekti i rivlerësimit deklaroi se kjo shumë i është lënë në ruajtje asaj, ajo vetë ia ka lënë në disponim bashkëshortit të saj. Kështu, përpos faktit se kjo shumë nuk i është nënshtruar pjesëtimit vullnetar në vitin 2014, pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë ligjore të babait, me depozitimin e saj në llogarinë e personit të lidhur, ajo trajtohet si të kishte qenë pjesë e pasurisë së përbashkët bashkëshortore. Madje, rezultoi se bashkëshorti i saj, ka përfutur interesa nga depozitimi i kësaj shume në sistemin bankar. Gjithashtu, pavarësisht se nëpërmjet deklaratave noteriale të depozituara mbas dërgimit të rezultateve të hetimit, motrat e subjektit deklarojnë se ato janë në dijeni të lënies dhe mbajtjes në ruajtje të kësaj shume nga subjekti i rivlerësimit, kjo nuk provon në mënyrë bindëse se ato kanë pasur dijeni më parë mbi këtë shumë të pretenduar të lënë në ruajtje apo dhe mbi faktin e deklaruar/konstatuar se ajo disponohet nga bashkëshorti i motrës së tyre.

d. Së katërti, lidhur me pretendimet e ngritura mbi mënyrën e deklarimit të likuiditeteve, Komisioni i qëndron konstatimit fillestar se në DIP/2010, subjekti ka deklaruar gjendje të likuiditeteve në formë *cash*, sigurisht e vlerësuar kjo rrethanë në harmoni me deklaratimet e mëparshme dhe vijuese të bëra nga subjekti mbi disponimin e likuiditeteve, pra duke u ndjekur logjika e deklarimit të saj dhe personit të lidhur.

**66.** Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar krijimin në datën 11.3.2011, të pasurisë së llojit “depozitë”, në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” me gjendje në vlerën rreth 21,300 euro, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

## Çështje të tjera

### **67. Apartamenti i ndodhur në Tiranë**

**67.1** Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, pjesë e dosjes së hetimit administrativ, Komisioni konstatoi disa transaksione të kryera nga personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, D.M, në “Tirana Bank”<sup>60</sup>, nga ku, ndër të tjera, rezultoi se:

**i.** në datën **15.2.2007**, personi i lidhur ka transferuar në një llogari tjetër vlerën **31,000 euro**, me përshkrimin “*Firma “\*\*\*” sh.p.k., Tiranë, pagesë kësti shtëpie*”.

**ii.** në datën **19.4.2007**, personi i lidhur ka transferuar në një llogari tjetër shumën prej **25,000 euro**, me përshkrimin “*\*\*\* sh.p.k., lik kësti shtëpie*”.

<sup>60</sup> Shkresa e “Tirana Bank” me nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2020, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2020.

**67.2 E pyetur më parë nga ILDKPKI** mbi pagesat e kryera në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., arsyet e mosdeklarimit të apartamentit, si edhe burimin e krijimit të këtyre shumave të transferuara (të kryera nga personi i lidhur), në datën 2.2.2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se<sup>61</sup> *apartamenti në Tiranë është porositur nga bashkëshorti në vitin 2007, për llogari të prindërve të saj. Aktualisht apartamenti është i regjistruar në emrin e nënës së saj*<sup>62</sup>. Për blerjen e këtij apartamenti nga prindërit e saj, ka kontribuar edhe ajo me sa mban mend në shumën rreth 2,000,000 lekë. Në vitin 2007 ka pakësuar gjendjen e llogarisë bankare pranë “Tirana Bank”, në shumën rreth 8,000 euro, të deklaruar në vitin 2006. Po kështu, ka pakësuar shumën 1,000,000 lekë, pranë “Intesa SanPaolo Bank” dhe rreth 200,000 lekë të pakësuar, pranë “Raiffeisen Bank”, veprime financiare të verifikueshme.

**67.2.1** Ndërsa, mbi mundësinë financiare të prindërve të saj për blerjen e këtij aseti, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *prindërit pa dyshim kanë patur kursimet e tyre nga puna ndër vite, por përveç saj, kanë kontribuar edhe dy motrat, të cilat punojnë dhe jetojnë në Greqi, qysh para vitit 1996.*

**67.3** E pyetur nga Komisioni<sup>63</sup> nëse ka transferuar ndonjëherë ndonjë shumë të barazvlefshme me 500 euro apo më të lartë në Shqipëri, apo jashtë saj, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *për shkak të gjendjes shëndetësore të babait, B.Ç, prindërit e saj shfaqën dëshirën për të jetuar në Tiranë, për arsye se duke qenë kujdesi shëndetësor më i mirë në Tiranë dhe për të qenë më afër mjekëve. Për këtë çështje është biseduar nga babai me mikun e tij, S.J, që kishte fime ndërtimi në Tiranë, i cili i ofroi babait një apartament në një nga pallatet që ai po ndërtonte, kundrejt shumës 56,000 euro. Duke qenë se babai nuk kishte një mundësi të tillë financiare, ajo dhe bashkëshorti vendosën të kontribuonin dhe si shenjë respekti për kujdesjen që prindërit kanë bërë në rritjen e dy fëmijëve të tyre dhe gadishmërinë e tyre për t'i plotësuar dëshirën.*

**67.3.1** Në vijim të deklarimit të bërë, subjekti ka referuar se konkretisht veprimet e kryera paraqiten si më poshtë vijon:

i. Në datën 5.2.2007, bashkëshorti, D.M, transferon 1,420,235 lekë nga llogaria e depozitës pranë “Tirana Bank” te llogaria e tij rrjedhëse në këtë bankë;

ii. Në datën 5.2.2007, bashkëshorti, D.M, derdh në llogarinë e tij rrjedhëse pranë “Tirana Bank” shumën 4,200 euro, të cilat ia kishte dhënë babai i saj, i ndjeri B.Ç. Këto para babai i kishte mbledhur nga kontributet e dhëna nga motrat e saj;

iii. Në datën 6.2.2007, bashkëshorti, D.M, tërheq 940,000 lekë nga llogaria e tij pranë “Intesa SanPaolo”, nga të cilat 900,000 lekë depozitohen të llogaria e tij rrjedhëse pranë Tirana Bank, bashkë me 900,000 lekë të cilat ia kishte dhënë babai i saj, B.Ç. Këto para babai i kishte mbledhur nga kontributet e dhëna nga motrat e saj;

iv. Në datën 15.2.2007, bashkëshorti tërheq shumën 2,510 USD, nga llogaria e tij kursimeve pranë “Tirana Bank”;

v. Po në datën 15.02.2007, bashkëshorti, D.M, tërheq nga llogaria e tij rrjedhëse pranë “Tirana Bank” shumën 3,200,162 lekë (shumë e cila është krijuar nga transferta 1,420,535 lekë + derdhja 1,800,000 lekë). Këtë shumë, plus shumën prej 2,510 usd, bashkëshorti i saj i ka këmbyer në euro dhe kryen derdhje prej 27,460 eurosh te llogaria e tij rrjedhëse në euro pranë kësaj banke.

vi. Po në datën 15.2.2007, bashkëshorti, D.M, kryen një transfertë në shumën 31,000 euro në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në Tiranë, shoqëria e cila do të shiste apartamentin;

<sup>61</sup> Referoju procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive”, të datës 2.2.2015, përcjellë me shkresën e ILDKPKI-së me nr. \*\*\* prot., datë 15.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2020).

<sup>62</sup> Në mbështetje të deklarimeve të dhëna subjekti ka depozituar kopje të kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme (apartament), me nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.10.2012.

<sup>63</sup> Pyetja nr. 18 e pyetësorit nr. 1.

- vii. Në datën 18.4.2007, bashkëshorti, D.M, transferon nga llogaria e tij e depozitës në euro pranë “Tirana Bank” te llogaria e tij rrjedhëse pranë së njëjtës bankë shumën 22,184 euro;
- viii. Në datën 18.4.2007, subjekti ka tërhequr nga llogaria e pagës pranë “Raiffeisen Bank” shumën 450,000 lekë, të cilën ia ka dhënë bashkëshortit;
- ix. Pasi kryen këmbimin e një pjese të shumës 450,000 lekë bashkëshorti derdh në llogarinë e tij rrjedhëse në euro pranë “Tirana Bank” shumën 2,162 euro;
- x. Në datën 19.04.2007, bashkëshorti, D.M, kryen një transfertë në shumën 25,000 euro në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**67.3.2** Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se kontrata e shitjes është finalizuar në vitin 2012, pasi firma e ndërtimit ka bërë me vonesë hipotekimin e objektit. Aktualisht ky apartament është në pronësi të nënës B.Ç.

**67.4** Në kushtet kur nga hetimi administrativ i kryer rezultoi se babai i subjektit në periudhën e kryerjes së transaksioneve të mësipërme ka pasur llogari bankare aktive në banka të nivelit të dytë në emrin e tij, Komisioni i kërkoi subjektit të japi shpjegime se përse nuk janë kryer nga llogaria e babait të saj pagesat me burim të referuar nga të ardhurat / kursimet e tij<sup>64</sup>. Në përgjigjet e dhëna Komisionit, subjekti i rivlerësimit deklaroi se *këto pagesa janë kryer nga bashkëshorti për shkak të gjendjes shëndetësore dhe moshës së madhe të prindërve të saj dhe faktit që nuk ishin të familjarizuar me këto lloj transaksionesh.*

**67.5** Ndërsa, e pyetur se mbi cilin akt/dokument (si kontratë porosie, aktmarrëveshje etj.) janë kryer pagesat në vitin 2007, në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për pasurinë objekt vlerësimi – apartamentin në Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *për shkak të marrëdhënies miqësore të babait me administratorin e shoqërisë së ndërtimit, z. S.J dhe mirëbesimit reciprok që lindte nga kjo marrëdhënie, asnjë nga palët nuk e konsideroi të nevojshme formalizimin e marrëveshjes të përfunduar verbalisht me një kontratë me shkrim. Për këtë arsye të gjitha pagesat janë kryer në bazë të marrëveshjes verbale dhe nuk disponohet asnjë akt i formalizuar.*

**68.** ASHK-ja, Drejtoria Vendore Rurale 1, informon<sup>65</sup> se në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. B.Ç, figuron e regjistruar pasuria me nr. \*\*\*, volum \*\*\*, faqe \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar lidhur me këtë pasuri rezulton se në datën 15.12.2012, nëna e subjektit të rivlerësimit, B.Ç, ka blerë<sup>66</sup> nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e llojit “apartament” me sipërfaqe të shfytëzueshme 95 m<sup>2</sup>, të ndodhur në godinën e ndërtuar nga shoqëria e sipërcituar, në \*\*\*, Tiranë, për çmimin 7,300,000 lekë. Në referim të kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, shitësi ka deklaruar se ka marrë nga blerësja vlerën e shitjes me këste jashtë zyrës noteriale dhe se janë shlyer totalisht midis tyre gjatë fazës së ndërtimit deri në përfundimin e plotë të godinës.

**69.** Pas kërkesës së bërë nga Komisioni<sup>67</sup>, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., informon se, në funksion të pasurisë së sipërcituar (blerë nga nëna e subjektit në vitin 2012), personi i lidhur, z. D.M, ka kryer dy pagesa, si vijon: i) pagesa e parë është kryer në datën 15.2.2007 në vlerën 31,000 euro; dhe ii) pagesa e dytë është kryer në datën 19.04.2007 në shumën 25,000 euro, duke dërguar bashkëlidhur përgjigjes kopje të dokumenteve “Nxjerrje llogarie” të shoqërisë, nga ku konfirmohen se këto pagesa janë kryer nëpërmjet transfertave bankare.

**70.** Gjithashtu, në vijim të verifikimeve të kryera mbi llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. D.M, Komisioni konstatoi se përgjatë vitit 2012 e në vijim, nga

<sup>64</sup> Pyetja nr. 20 e pyetësorit nr. 2.

<sup>65</sup> Shkresa e ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, me nr. \*\*\* prot., datë 1.2.2021, protokolluar në Komision me nr. \*\*\*prot., datë 4.2.2021.

<sup>66</sup> Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme (apartament), me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.10.2012, redaktuar nga noteri publik, znj. M.B.

<sup>67</sup> Shkresa e Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 5.11.2021.

llogaria e tij në BKT<sup>68</sup>, janë kryer disa pagesa për shërbime utilitare<sup>69</sup> me përshkrimin “*Likujdim ujë...A...dhe CEZ*”.

**70.1** E pyetur nga Komisioni mbi këto pagesa<sup>70</sup>, duke i kërkuar të deklarojë se me cilën pasuri lidhen dhe abonentin në emër të të cilit janë lidhur kontratat e shërbimit, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar se pagesat e kryera për furnizimin me ujë, që lidhen me kontratën me nr. \*\*\* dhe për furnizimin me energji elektrike, që lidhen me kontratën me nr. \*\*\*, i përkasin apartamentit në Tiranë, të regjistruar në emër të nënës së saj, znj. B.Ç.

**70.2** Në mbështetje të deklarimeve të bëra subjekti ka depozituar kopje të librezave të energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë, në emër të nënës së saj, B.Ç, të cilat pasqyrojnë pagesa të kryera për periudhën nga viti 2018 e në vijim.

**70.3** Pas kërkesës së bërë nga Komisioni<sup>71</sup>, OSHEE (Furnizuesi i Shërbimit Universal – FSHU)<sup>72</sup> konfirmon se nëna e subjektit, znj. B.Ç, ka kontratë për furnizimin me energji elektrike nr. \*\*\*, me kod klienti \*\*\*, të hapur në datën 21.7.2009. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar konfirmohet se kjo kontratë lidhet me apartamentin e ndodhur në \*\*\*, Tiranë (pasuria objekt vlerësimi), të regjistruar në emër të nënës së subjektit. Por, nga ana tjetër rezulton se fillimisht për këtë apartament është lidhur kontratë nga D.M dhe se lidhja e kontratës në emër të nënës së subjektit, ndryshimi i abonentit, është bërë në vitin 2018<sup>73</sup>.

**70.4** Po ashtu, pas kërkesës së bërë nga Komisioni<sup>74</sup>, Ujësjellës - Kanalizime Tiranë (UKT)<sup>75</sup> sh.a., konfirmon se kontrata me nr. \*\*\*, rezulton në emër të nënës së subjektit, znj. B.Ç, për objektin me adresë rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, duke dërguar bashkëlidhur kopje të certifikatës së pronësisë me nr. \*\*\*, e cila i përket pasurisë objekt vlerësimi. Por, edhe në këtë rast në referim të dokumentacionit të dërguar nga UKT, kjo kontratë rezulton të jetë hapur fillimisht në emër të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, D.M.

**71.** Sa më sipër, në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit 84/2016, në kushtet kur rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur lidhje interesi me prindërit e saj, ata kategorizohen në cilësinë e “personave të tjerë të lidhur”, kjo në funksion edhe të deklaramit dhe verifikimit të çdo shtate të mundshme të konfliktit të interesit.

**71.1** Në këtë këndvështrim, Komisioni, krahas mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, kreu verifikime edhe mbi mundësinë financiare të prindërve të subjektit që lidhet me pagesat e referuara për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi.

**72.** Nga hetimi administrav i kryer rezultoi se bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht depozitimin dhe transferimin në vitin 2007 të vlerës monetare në shumën prej 56,000 eurosh, në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., kjo pasi: (i) nuk disponon dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e pretenduara si të realizuara prej tij për periudhën 2004 – 2007, nga puna në emigracion në shtetin grek dhe puna \*\*\* në Shqipëri; si dhe (ii) ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura vetëm nga pensioni i pleqërisë dhe se nuk u përcaktua në vlerë kontributi i motrave të saj – të referuara si të dhëna babait dhe as periudha kur i janë dhënë këto shuma, me qëllim verifikimin/analizimin e mundësisë së tyre financiare.

<sup>68</sup> Shkresa e BKT me nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2020, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 23.12.2020.

<sup>69</sup> Pagesa për kontratën me numër \*\*\* me përshkrimin “*Likuidim ujë*”; pagesë për kontratën numër \*\*\* me përshkrimin “*A*”; dhe pagesë për kontratën numër \*\*\* me përshkrimin “*CEZ*”.

<sup>70</sup> Njëpërmjet pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni.

<sup>71</sup> Shkresa e Komisionit me nr.\*\*\* prot., datë 24.1.2022.

<sup>72</sup> Shkresa e OSHEE-së me nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2022, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 9.2.2022.

<sup>73</sup> Shiko kopje të dokumenteve të dërguara nga OSHEE: Librezë energjie elektrike; certifikatë për vërtetim pronësie; dhe (praktikën shkresore të mbajtur për ndryshimin e abonentit.

<sup>74</sup> Shkresa e Komisionit me nr. \*\*\*\* prot., datë 24.1.2022.

<sup>75</sup> Shkresa e UKT-së me nr. \*\*\* prot., datë 04.02.2022, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2022.

**73.** Në rrethanën e mungesës së provueshmërisë së ligjshmërisë së burimeve financiare për kryerjen e pagesave për blerjen e kësaj pasurie, të vlerësuar në harmoni me provat dhe indiciet e tjera të cilat e lidhin subjektin / personin e lidhur me pasurinë objekt vlerësimi, apartamentin në Tiranë, ekzistojnë dyshime të arsyeshme se në këtë rast kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, mbajtur/regjistruar në emër të personave të tjerë të lidhur (prindërve të saj), me qëllim shmangien e kontrollit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të saj.

**74.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për të dhënë argumentet/shpjegimet dhe provat e tij në lidhje me konstatimin e mësipërm se, në këtë rast kemi të bëjmë me situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mund të mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**75.** Komisioni vëren se, me dërgimin e prapësimeve subjekti u ka qëndruar shpjegimeve të dhëna më parë gjatë hetimit administrativ e në mënyrë të përmbledhur ka argumentuar duke parashtruar se:

(i) Ajo dhe personi i lidhur, bashkëshorti, kanë kontribut në blerjen e kësaj pasurie dhe se ky fakt është deklaruar më parë në ILDKPKI dhe gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, por se ata kanë gabuar në plotësimin e deklaratës së interesave privatë peridokë të vitit 2007, duke mos deklaruar pakësim të pasurisë;

(ii) Komisioni ka gabuar në kryerjen e analizës financiare të prindërve të saj, pasi ata nuk mund të kategorizohen në cilësinë e personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe as gjenden në kushtet e parashikuara në nenin 32/4, të ligjit 84/2014, pra në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit apo huamarrësit, dhe si të tillë, të kishin detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive;

(iii) Sa u përket librezave të energjisë dhe ujit të bëra në emrin e bashkëshortit të saj, ajo pretendon se ato janë bërë nga firma ndëruese, sipas praktikës së kohës dhe se arsyeja që mund të ketë ndodhur është se ka qenë bashkëshorti i saj që ka ndjekur fazat e punimeve, pra se atë njihnin, duke deklaruar se bashkëshorti i saj nuk ka nënshkruar ndonjë kontratë;

(iv) Në asnjë rast prej tyre nuk është mohuar kryerja e pagesave utilitare për shërbime që lidhen me këtë pasuri, porse kjo nuk do të thotë se ata janë pronarë të saj.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**76.** Pas verifikimit të dokumentacionit bankar, pjesë e dosjes së hetimit administrativ të kryer, Komisioni, ndër të tjera, konstatoi se gjendjet e llogarive bankare në disa banka të nivelit të dytë të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, bashkëshortit D.M, për vitet 2002, 2003, 2004, 2005, 2006 dhe 2007, paraqiten si më poshtë:

**a.** Për vitin 2002, gjendja e llogarive bankare në datën 31.12.2002, paraqitet: (i) gjendje e llogarisë depozitë e personit të lidhur në “Tirana Bank”, vlera 400,000 lekë; dhe (ii) gjendje e llogarisë depozitë e personit të lidhur në “Tirana Bank”, vlera 2,500 euro.

Rezulton se në fund të vitit 2002, subjekti dhe personi i lidhur dispononin gjendje pasurinë e llojit likuiditete, të materializuar në llogari bankare, në total shumën rreth 743,00 lekë<sup>76</sup>.

**b.** Për vitin 2003, gjendja e llogarive bankare në datë 31.12.002, është me vlerë 0 lekë/valutë.

Rezulton se përgjatë vitit 2003 janë tërhequr plotësisht fondet e disponuara në llogaritë bankare të personit të lidhur në “Tirana Bank”. Në kushtet kur vlerat, gjendje në llogaritë bankare të personit të lidhur në fund të vitit 2002, janë krijuar gjatë kohës që subjekti ka qenë i lidhur në

<sup>76</sup> Vlerat e konstatuara si gjendje në llogari bankare në valutë, janë konvertuar sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, të datës 31 dhjetor të vitit përkatës (referuar faqes zyrtare të Bankës së Shqipërisë).

martësë ligjore, Komisioni ka vlerësuar se në krijimin e tyre mund të ketë kontribut edhe subjekti dhe se tërheqja e kësaj shume gjatë vitit 2003 është reflektuar si burim i mundshëm, i cili mund të ketë shërbyer për blerjen e apartamentit në Gjirokastrë.

**c.** Për vitin 2004, gjendja e llogarive në datën 31.12.2004, paraqitet: (i) gjendje e llogarisë depozitë e personit të lidhur në “Tirana Bank”, vlera 1,312,748 lekë; (ii) gjendja e llogarisë depozitë e personit të lidhur në “Tirana Bank”, vlera 8,516 euro; (iii) gjendja e llogarisë rrjedhëse e personit të lidhur në “Tirana Bank”, vlera 600,355 lekë; (iv) gjendja e llogarisë depozitë e personit të lidhur në “Tirana Bank”, vlera 1,500 USD.

Rezulton se **në fund të vitit 2004**, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur dispononin gjendje pasurinë e llojit likuiditete, të materializuar në llogari bankare, në total shumën rreth 3,134,000 lekë.

**d.** Për vitin 2005, gjendja e llogarive në datë 31.12.2005, paraqitet: (i) gjendje e llogarisë depozitë e personit të lidhur në “Tirana Bank”, vlera 1,364,716 lekë; (ii) gjendja e llogarisë depozitë e personit të lidhur në “Tirana Bank”, vlera 11,153 euro; (iii) gjendja e llogarisë depozitë e personit të lidhur në “Tirana Bank”, vlera 1,525 USD; (iv) gjendja e llogarisë e personit të lidhur në “Intesa SanPaolo Bank”, vlera 1,099,800 lekë; dhe (v) gjendje e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank”, vlera 130,409 lekë;

Rezulton se në fund të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur dispononin gjendje pasurinë e llojit likuiditete, të materializuar në llogari bankare, në total shumën rreth 4,121,000 lekë.

**e.** Për vitin 2006, gjendja e llogarive në datën 31.12.2006, paraqitet: (i) gjendje e llogarisë depozitë e personit të lidhur në “Tirana Bank”, vlera 1,409,662 lekë; (ii) gjendja e llogarisë depozitë e personit të lidhur në “Tirana Bank”, vlera 21,923 euro; (iii) gjendja e llogarisë depozitë e personit të lidhur në “Tirana Bank”, vlera 2,050 USD; (iv) gjendja e llogarisë e personit të lidhur në “Intesa SanPaolo Bank”, vlera 1,123,704 lekë; (v) gjendje e llogarisë së subjektit në “Raiffeisen Bank”, vlera 475,816 lekë;

Rezulton se në fund të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur dispononin gjendje pasurinë e llojit likuiditete, të materializuar në llogari bankare, në total shumën rreth 5,915,000 lekë.

**f.** Rezulton se në fund të vitit 2007 (datë 31.12.2007), gjendja totale e llogarive të subjektit dhe personit të lidhur është në vlerën rreth 195,000 lekë, pjesa më e madhe e së cilës ndodhet gjendje në llogarinë e pagës së subjektit (vlera 191,656 lekë).

**77.** Ndërsa, referuar deklaratave të interesave privatë periodikë vjetorë, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI, rezulton se: (i) në DIP/2004, subjekti dhe/apo personi i lidhur nuk kanë deklaruar pasuri të llojit “likuiditete”, gjendje në llogari bankare; (ii) në DIP/2005, në seksionin e të ardhurave personi i lidhur ka deklaruar: “*Të ardhura për vitin 2005 nga emigracioni – Banka e Tiranës, shuma prej 4,000 euro*”; (iii) në DIP/2006, në seksionin e të ardhurave, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (a) “*Të ardhura të krijuara nga veprimtaria private e bashkëshortit, D.M, si \*\*\* në objektin Spitali i Qytetit (Sarandë), Delvinë, depozituar në nr. llogarisë \*\*\* të kartës (Raiffeisen Bank), vlerën prej 230,000 lekë*”; (b) “*Të ardhura dhe kursime bankare të bashkëshortit, D.M, nga aktiviteti i tij privat dhe emigracioni, “Tirana Bank”, vlera 8,000 euro dhe “Banka Amerikane”, vlera 1,000,000 lekë*”; dhe se (iv) në DIP/2007, nuk është deklaruar pakësimi i likuiditeteve gjendje në llogari bankare. Gjithashtu, Komisioni vëren se përgjatë këtyre viteve (viteve 2003 – 2006) subjekti nuk ka deklaruar mbi disponimin e likuiditeteve në gjendje *cash*.

**78.** Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur nuk kanë deklaruar saktësisht shtesat/pakësimet/gjendjet e llogariave bankare për vitet 2004 – 2007. Në këtë kuptim rezulton se subjekti nuk ka deklaruar plotësisht pasuritë e llojit “likuiditete”, të

materializuara në llogari të ndryshme bankare të saj dhe personit të lidhur, me gjendje totale në fund të vitit 2006, në shumën rreth 5,5 milionë lekë, pakësimi i të cilave rezulton të ketë shërbyer për likuidimin e pagesës së çmimit të apartamentit në Tiranë.

**79.** Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i qartë dhe koherent në deklarimin e bërë mbi kontributit e dhënë prej saj dhe personit të lidhur, e konkretisht mbi shumën e të ardhurave të tyre, të cilat kanë shërbyer për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi.

**79.1** Kështu, referuar deklarimeve të dhëna në ILDKPKI, në shkurt të vitit 2015, subjekti ka shpjeguar se për blerjen e kësaj pasurie ka kontribuar edhe ajo me sa mban mend në shumën rreth 2,000,000 lekë, pasi në vitin 2007 ka pakësuar gjendjen e llogarisë bankare në “Tirana Bank”, në shumën rreth 8,000 euro, të deklaruar në vitin 2006, po kështu ka pakësuar shumën prej 1,000,000 lekë, pranë “Intesa SanPaolo Bank” dhe rreth 200,000 lekë të pakësuar, pranë “Raiffeisen Bank”.

**79.2** Por, sikurse u konstatua edhe më sipër, gjendja totale e llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, bashkëshortit, në fund të vitit 2006, është në total në shumën rreth 5.5 milionë lekë. Në këtë kuptim, rezulton se deklarimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI lidhet me deklarimin e bërë më parë prej saj në DIP/2006, mbi gjendjen e likuiditeteve në llogari bankare të bashkëshortit të saj.

**79.3** Ndërsa, gjatë hetimit administrativ, pasi subjekti ka referuar 2 (dy) pagesat e kryera me transfertë bankare nga bashkëshorti i saj në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., e konkretisht pagesën e kryer në datën 15.02.2007, në shumën 31,000 euro dhe pagesën e kryer në datë 19.4.2007, në shumën 25,000 euro, ka deklaruar se në krijimin e këtyre shumave të transferuara ka kontribuar edhe babai i saj me vlerat monetare prej 4,200 eurosh dhe 900,000 lekë (në shkurt të vitit 2007), të cilat babai i kishte mbledhur nga kontributet e dhëna nga motrat e saj.

**80.** Nisur nga vetëdeklarimi i bërë, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka shpenzuar në total shumën rreth 11,700 euro për pasurinë objekt vlerësimi, apartamentin në Tiranë. Si rrjedhim, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj të kenë qenë financuesit/investitorët kryesorë në pagesën e çmimit të kësaj pasurie, pasi sipas vetëdeklarimeve ata kanë paguar shumën prej 44,300 eurosh<sup>77</sup>.

**80.1** Për sa më sipër, bazuar në deklaratimet e bëra, si edhe pas verifikimit të lëvizjeve të llogarive bankare, trupi gjykues arrin në përfundimin se, së paku, pjesa kryesore e çmimit të paguar për blerjen e kësaj pasurie (vlera 44,300 euro) është paguar me fondet e disponuara në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, bashkëshortit, të krijuara përgjatë viteve 2004 – 2006.

**81.** Gjithsesi, trupi gjykues çmon se dyshimet e ngritura mbi këtë pasuri nuk kanë të bëjnë vetëm me faktin se janë kryer pagesa për likuidimin e çmimit të saj me të ardhura nga burime financiare të subjektit dhe/apo personit të lidhur, pasi është e drejta e tyre të përdorin sipas dëshirës kursimet, porse ato kanë të bëjnë me faktin e mosdeklarimit në kohë të vlerave të depozituara dhe të krijuara në llogari bankare, transfertave të kryera në vitin 2007 dhe qëllimin e kryerjes së tyre. Parë në këtë këndvështrim, rezulton se janë bërë përpjekje për shmangien e verifikimit të ligjshmërisë së krijimit të gjendjeve të llogarive bankare deri në fund të vitit 2006 dhe depozitimeve të kryera në vitin 2007. Në vijim të arsytimit, referuar analizës financiare përfundimtare të kryer nga Komisioni, kanë rezultuar me balancë negative fondesh vitet gjatë të cilat janë krijuar gjendjet e këtyre llogarive, pra se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurive të llojit “likuiditete” gjendje në llogari bankare dhe shtesave të tyre, përgjatë viteve 2004 – 2006<sup>78</sup>. Në këtë kuadër, Komisioni vlen të theksojë se subjekti i rivlerësimi nuk ka arritur të provojë me

<sup>77</sup> Vlera totale e konstatuar si e paguar në vitin 2007 me transfertë bankare në shumën prej 56,000 euro – (minus) vlerën e deklaruar si të dhënë nga babai i subjektit në shumën prej rreth 11,700 euro = 44,300 euro.

<sup>78</sup> Referoju tabelës përmbledhëse të analizës financiare, aneksi 1, pjesë e këtij vendimi.

dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e pretenduara si të krijuara për këtë periudhë nga puna e bashkëshortit në emigracion dhe nga puna e tij si \*\*\* në Shqipëri.

**82.** Sa i përket pretendimit të subjektit se prindërit e saj nuk mund të trajtohen në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, të tillë që, në kuptim të nenit 32/4, të ligjit nr. 84/2016, të kenë detyrimin për të justifikuar pasuritë, e në këtë rast bazuar në parimin e proporcionalitetit të shumës prej 11,700 eurosh (të pretenduar si të dhënë prej babait të saj – e cila sipas vetëdeklarimit ka shërbyer për pagesat e kryera për blerjen e apartamentit në Tiranë), trupi gjykues arsyeton se, në përputhje me pikën 14 të nenit 3 të ligjit 84/2016, në kushtet kur rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur lidhje të vazhdueshme interesi me prindërit e saj, e konkretisht edhe mbi pasurinë objekt vlerësimi, ata kategorizohen në cilësinë e “personave të tjerë të lidhur”, kjo në funksion edhe të deklarimit dhe verifikimit të çdo shtate të mundshme të konfliktit të interesit.

**82.1** Referuar ligjit nr. 84/2016, si edhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit<sup>79</sup>, interesi pasuror që i vendos personat e tjerë të lidhur në kushtet e detyrimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë është përcaktuar në pikën 4 të nenit 32 të tij, pra se duhet të jetë një marrëdhënie dhurimi, huamarrje ose huadhënie me subjektin e rivlerësimit. Por, kjo nuk mund të cenojë apo të shmangë detyrimin që ka Komisioni për të kryer hetime për çdo pasuri për të cilën ka të dhëna apo dyshime të arsyeshme se është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, pavarësisht se mbahet në emër të personave të tjerë të lidhur apo shtetasve të tjerë, të cilët nuk kanë asnjë lidhje me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të përcaktimeve të nenit 3, pika 14 e këtij ligji.

**82.2** Pra, nisur nga fakti i konstatimit të pagesave të kryera nga personi i lidhur për likuidimin e çmimit të blerjes së kësaj pasurie, vetëdeklarimit të bërë mbi kontributin e dhënë në pagesën e kryer, si edhe nisur nga të dhënat e provuara dhe indiciet të tjera që e lidhin subjektin e rivlerësimit me këtë pasuri, Komisioni vlerësoi se në këtë rast kemi të bëjmë me situatë të dyshuar se personat e tjerë të lidhur mund të mbajnë pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

**82.3** Në këtë kuadër, në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit<sup>80</sup>, Komisioni vendosi të thellojë hetimet dhe të verifikojë, krahas mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për investimet e vetëdeklaruar mbi këtë pasuri, edhe mundësinë financiare të personave të tjerë të lidhur (prindërve të subjektit) sa i përket kryerjes në tërësi të pagesës së çmimit të blerjes për pasurinë objekt vlerësimi, pavarësisht se në këtë rast ata, në cilësinë e personave të tjerë të lidhur, nuk janë në kushtet e parashikuara në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, por kjo vlerësuar si një rrethanë dhe indicie e rëndësishme në verifikim të situatës së dyshuar për fshehje pasurie.

**83.** Gjithsesi, duke dashur të risjellë në vëmendje se nuk është deklaruar në deklaratën e interesave privatë të vitit 2007 dhënia e këtyre shumave nga babai i subjektit dhe qëllimi i përdorimit të tyre, pra edhe pse mbetet kryesisht i karakterit deklarativ pretendimi i bërë nga subjekti gjatë hetimit administrativ se në vitin 2007 bashkëshorti i saj ka depozituar në llogarinë e tij 2 (dy) vlera monetare me burim të ardhurat e babait të saj, Komisioni për të garantuar një qasje sa më afër së vërtetës, vlerësoi të pranojë këtë pretendim dhe të verifikojë ligjshmërinë e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur, babait të subjektit.

**84.** Me dërgimin e prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka depozituar 2 (dy) deklaratatë noteriale të motrave të saj<sup>81</sup>, M.M dhe L.GJ, nëpërmjet të cilave kërkon të provojë se shuma e pretenduar si dhënë nga babai i saj për pagesat e transferuara në favor të shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., ka si burim të ardhurat e tyre nga puna në emigracion, në shtetin grek. Por, nga ana tjetër Komisioni

<sup>79</sup> Shiko paragrafin 74, në faqet 29 dhe 30 të vendimit të Kolegjit të Apelit me nr. \*\*\*, datë 10.9.2020.

<sup>80</sup> Shiko paragrafet 109 dhe 110, në faqet 34 dhe 35, të vendimit të Kolegjit të Apelit me nr. \*\*\*, datë 17.7.2019.

<sup>81</sup> Deklaratë noteriale me nr. \*\*\*rep., nr \*\*\* kol., datë 10.9.2022 dhe deklaratë noteriale” me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.9.2022.

konstaton se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor (në formën e kërkuar nga ligji) për të provuar krijimin e këtyre të ardhurave.

**85.** Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se personi tjetër i lidhur, babai i subjektit të rivlerësimit, nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhënien në vitin 2007, të vlerave monetare 4,200 euro dhe 900,000 lekë, të deklaruara nga subjekti si të depozituara në llogaritë bankare të bashkëshortit të saj dhe se në vijim pasi janë bashkuar me vlera të tjera të disponuara nga personi i lidhur, janë transferuar në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi.

**86.** Gjithashtu, fakti i vendosjes së emrit të personit të lidhur në librezat e shërbimeve utilitare mbi këtë pasuri, si edhe kryerja nga ky i fundit i disa pagesave që lidhen me ofrimin e këtyre shërbimeve, vërtet nuk tregon “*apriori*” pronësinë e tij mbi sendin, por nga ana tjetër trupi gjykues çmon se edhe këto rrethana të konstatuara vlerësohen si të dhëna/fakte/indicie të rëndësishme në kuadrin e verifikimit të situatës së dyshuar për fshehje pasurie. Gjithashtu, është e vërtetë që Komisioni nuk administroi kontrata të lidhura nga bashkëshorti i subjektit me operatorët OSHEE dhe UKT dhe se as nuk arriti të provojë se mbi bazën e cilit dokument është shënuar emri i personit të lidhur në librezat përkatëse, por nga ana tjetër edhe subjekti, pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**86.1** Vlen të theksohet se vetëm në vitin 2018 është realizuar ndryshimi i emrit të abonentit/klientit në dokumentacionin e operatorëve përkatës, të cilët kanë vënë në dispozicion të Komisionit dokumentin, certifikatë për vërtetim pronësie, mbi bazën e të cilit kanë bërë ndryshimet përkatëse. Thënë ky fakt, nuk përjashtohet mundësia që të ketë ekzistuar kontratë e mëparshme porosie/sipërmarrjeje e lidhur mes bashkëshortit të subjektit dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për këtë pasuri, mbi bazën e të cilës është shënuar në librezat përkatëse emri i personit të lidhur si abonent/klient i operatorëve të shërbimeve të mësipërme.

Në këto rrethana, Komisioni vlerësoi rezultatin e analizës financiare të subjektit të rivlerësimit, personit të lidhur dhe personave të tjerë të lidhur, në harmoni me të dhënat dhe indiciet e tjera të cilat e lidhin subjektin/personin e lidhur me pasurinë objekt vlerësimi, si edhe me faktin që ata shfaqen në cilësinë e investitorëve kryesorë në blerjen e kësaj pasurie.

**87.** Si konkluzion, trupi gjykues, mbi bazën e fakteve, rrethanave dhe indicieve të besueshme krijoi bindjen se në këtë rast kemi të bëjmë me pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, mbajtur/regjistruar në emër të personave të tjerë të lidhur (nënës së saj), me qëllim shmangien e kontrollit të ligjshmërisë së burimeve financiare të krijimit të saj, duke e bërë atë të gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” të ligjit nr. 84/2016.

## **88. Verifikimi i transfertave të kryera në llogari të personit të lidhur, vitet 2006 – 2007**

**88.1** Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, pjesë e dosjes së hetimit administrativ, Komisioni konstatoi disa transferta të kryera në favor të personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, në llogarinë e tij “Intesa SanPaolo Bank”<sup>82</sup>, e konkretisht: (i) në datën 21.09.2006 është transferuar shuma 49,888 USD; (ii) në datën 6.10.2006 është transferuar shuma 14,946 USD; (iii) në datën 25.10.2006, është transferuar shuma 12,950 USD; dhe (iv) në datën 21.2.2007 është transferuar shuma 3,271 USD. Pra, rezulton se për periudhën shtator 2006 – shkurt 2007 është transferuar në favor të personit të lidhur, në llogarinë e tij në “Intesa SanPaolo Bank”, në total shuma 81,000 euro. Gjithashtu, Komisionin konstaton se këto vlera monetare janë tërhequr nga personi i lidhur, në kohë të afërt mbas transferimit të tyre.

**88.2** E pyetur nga Komisioni, nëse gjatë periudhës së deklarimit ka marrë apo ka nxjerrë jashtë Shqipërisë të holla (cash) në cilëndo lloj shume, mbi shumën e barasvlefshme me 500 euro,

<sup>82</sup> Shkresa e “Intesa SanPaolo Bank” me nr. \*\*\* prot., datë 14.12.2020, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 18.12.2020.

subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se<sup>83</sup> në vitet 2006 – 2007, në emër të bashkëshortit, D.M, janë transferuar katër shuma në dollarë nga vajza xhaxhait të saj, L.Ç dhe bashkëshorti i saj XH.C nga Amerika për blerjen e një shtëpie në emrin e tyre në Sarandë. Për veprimet e blerjes së apartamentit do të merrej shtetasi A.D, që është burri i motrës së L.Ç, vajzës tjetër të xhaxhait, E.D. Bashkëshorti i vajzës së xhaxhait, duke qenë shtetas amerikan, për sigurinë e tij, kërkoi që shuma që do të dërgonte të kalonin nëpërmjet një banke amerikane. Duke qenë se shtetasit A.D dhe E.D nuk kishin llogari të hapur në Bankën Amerikane dhe për mos të hapur një llogari tjetër në emrin e tyre, në mirëkuptim, midis të gjithave është vendosur të përdoret llogaria bankare në emër të bashkëshortit të saj. Për çdo transferim që i është bërë nga Amerika, pas dy- tre ditëve secila shumë është tërhequr nga bashkëshorti dhe i është dorëzuar cash në dorë shtetasit A.D. Angazhimi i tyre në lidhje me këtë çështje, kufizohet vetëm në lehtësimin e transferimit të parave dhe se ata nuk kanë informacion në lidhje me vazhdimësinë e çështjes dhe përdorimit të shumës.

**88.2.1** Në mbështetje të deklarimeve të saj, subjekti ka depozituar dokumentet si vijon: (i) deklaratë e shtetasve G.C dhe L.Ç, e përpiluar para noteri publik të shtetit \*\*\*, SHBA (ii) kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme<sup>84</sup>, e datës 11.10.2006; (iii) deklaratë noteriale e shtetasit A.D<sup>85</sup>, e datës 30.1.2015; (iv) prokurë e posaçme bërë në shtetin \*\*\*, SHBA, e datës 13.9.2006. Kontrata e shitblerjes, deklarata noteriale dhe prokura e posaçme rezultojnë të jenë administruar edhe në dosjen e ILDKPKI-së<sup>86</sup>. Krahas tyre, në dosjen e ILDKPKI-së gjendet një deklaratë me shkrim të lirë dore (shkresë e thjeshtë pa datë) në gjuhën shqipe, e nënshkruar nga shtetasit L.Ç dhe G.C.

**88.3** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar konstatohet se shtetasit L.Ç dhe G.C, pranojnë se i kanë transferuar këto vlera monetare në llogari të personit të lidhur për blerjen e një shtëpie në qytetin e Sarandës dhe për këtë qëllim i kanë dhëna tagra shtetasit A.D, për kryerjen e veprimeve të nevojshme për blerjen e apartamentit në emrin e tyre. Konfirmohet se në datën 11.10.2006, shtetasi A.D, përfaqësues me prokurë i shtetasve L.Ç dhe G.C, ka lidhur kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, apartament, të ndodhur në qytetin e Sarandës, në referim të së cilës është blerë kjo pasuri për çmimin 3,200,000 lekë. Gjithashtu, me anë të deklaratës noteriale të datës 30.1.2015, shtetasi A.D ka pranuar faktin se i ka marrë në dorëzime vlerat monetare të transferuara nga shtetasi G.C në llogarinë e personit të lidhur, pas tërheqjes së tyre nga ky i fundit, me qëllim blerjen e apartamentit në Sarandë.

**88.4** Në vijim të verifikimeve të këtyre transfertave të kryera në llogarinë e personit të lidhur, Komisioni kërkoi<sup>87</sup> nga “Intesa SanPaolo Bank” konfirmimin e urdhëruesit të këtyre transfertave, në përgjigje<sup>88</sup> të të cilit rezultoi emri i shtetasit të huaj G.A.C.

**88.4.1** Nga hetimi ka rezultuar se shuma e transferuar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit është më e lartë se vlera e blerjes së apartamentit në Sarandë dhe për më tepër dy transfertat janë kryer pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së apartamentit në Sarandë (shuma prej 12,950 USD, transferuar në datë 25.10.2006, dhe shuma prej 3,271 USD është transferuar në datë 21.2.2007).

**88.5** Pasi Komisioni i kërkoi sërish subjekti të japi shpjegime<sup>89</sup> mbi destinacionin e përdorimit të diferencës midis vlerës monetare të transferuar në llogarinë e tij bankare dhe vlerës së blerjes së apartamentit në Sarandë, subjekti u ka qëndruar shpjegimeve të dhëna më parë se nuk ka dijeni për destinacionin e kësaj shume, pasi ata (ajo dhe bashkëshorti) nuk ishin të autorizuar për të kryer veprime mbi shumën, po se angazhimi i tyre ishte vetëm në lehtësimin e transfertës të kryer

<sup>83</sup> Pyetja nr. 17 e pyetësorit nr. 1, të dërguar nga Komisioni.

<sup>84</sup> Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme, me nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.10.2006, redaktuar nga noteri publik, znj. N.T.

<sup>85</sup> Deklaratë noteriale” me nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 30.1.2015, redaktuar nga noteri publik, znj. A.D.

<sup>86</sup> Dokumentacion i ndodhur në aneksin \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>87</sup> Shkresa e Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2022.

<sup>88</sup> Shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 5.5.2022, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 10.5.2022.

<sup>89</sup> Pyetja nr. 18 e pyetësorit nr. 2.

nga njerëz të afërt të tyre, pra se ishin në marrëdhënie të posaçme familjare. Komisioni vëren se subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit.

**89.** Si konkluzion, trupi gjykues çmon se janë bindëse dhe të mbështetura në dokumentacion provues shpjegimet e dhëna nga subjekti mbi arsyet dhe qëllimin e kryerjes së këtyre transfertave, kjo edhe për shkak të marrëdhënies së posaçme mes personave të përfshirë në këto transaksione. Nga ana tjetër, në kushtet kur nuk pretendohet përdorimi i këtyre vlerave monetare nga subjekti i rivlerësimit dhe/apo personi i lidhur dhe se është pranuar nga shtetasi, A.D, marrja në dorëzim e tyre, çmohet i besueshëm deklarimi i bërë nga subjekti mbi padijeninë e përdorimit të plotë të tyre.

**90. Pasuria e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Sarandë, në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij.**

**90.1** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së<sup>90</sup> rezultoi se bashkëshorti i subjekti, D.M, ka të regjistruar në bashkëpronësi me familjarët e tij, pasurinë e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 77 m<sup>2</sup>, të ndodhur në qytetin e Sarandës. Referuar dokumentacionit tekniko - ligjor të kësaj pasurie rezulton se ajo është përfituar nga familja Marku me kontratën e shitblerjes të datës 14.5.1993, të lidhur me NKB, bazuar ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

**90.2** Komisioni konstatoi se personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, por as në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë pjesën takuese të tij mbi këtë pasuri.

**91.** Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve, edhe në këtë rast, subjekti referon disa rrethana të familjes së bashkëshortit, duke pretenduar se nuk kanë qenë në dijeni se ai zotëronte pjesë takuese mbi këtë pasuri të përfituar me ligjin e privatizimit.

**92.** Si konkluzion, në kushtet kur nuk ka dyshime mbi mënyrën e fitimit dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues çmon se edhe në rast të provueshmërisë së dijenisë së personit të lidhur për pjesën takuese të tij mbi këtë pasuri, mosdeklarimi i kësaj pasurie do të përbënte pasaktësi në deklaram me peshë specifike të vogël, e tillë që nuk ndikon në vendimmarrjen përfundimtare të Komisionit.

**93. Verifikime të kryera mbi adresën e banimit të deklaruar në Tiranë**

**93.1** Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë, të depozituara ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit në DIP/2012, 2013 dhe 2014 ka deklaruar si vendqëndrim tjetër, adresë banimi: “Njësia Bashkiake nr. \*\*\*, Tiranë”.

**93.2** Pas kërkesës së bërë nga Komisioni<sup>91</sup>, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile<sup>92</sup>, ndër të tjera, informon se, më 5.12.2012, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, D.M, kanë ndryshuar vendbanimin nga Bashkia Gjirokastrë dhe janë vendosur në Njësia Administrative nr. \*\*\*, Tiranë. Më 06.11.2014, kanë ndryshuar përsëri vendbanimin nga Njësia Administrative nr. \*\*\*, Bashkia Tiranë dhe janë vendosur në Gjirokastrë.

**93.3** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar nga kjo drejtori rezulton se këta shtetas janë regjistruar si banorë të kësaj njësie, bazuar në kontratën e qirasë<sup>93</sup> së datës 23.11.2012, në referim të së cilës, subjekti i rivlerësimit ka marrë me qira nga shtetasi D.A, një apartament në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, në vlerën 20,000 lekë në muaj, me afat kohor 1 vit me të drejtë ripërtëritjeje.

<sup>90</sup> Shkresa e ZVRPP-së Sarandë me nr. \*\*\* prot., datë 4.8.2017, administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>91</sup> Shkresa e Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2022.

<sup>92</sup> Shkresa e DPGJC, me nr. \*\*\* prot., datë 28.02.2022, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 02.03.2022.

<sup>93</sup> Kontratë qiraje pasurie e paluajtshme me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 23.11.2012, redaktuar nga noteri publik, znj. SH.GJ.

**93.4** Në vijim të verifikimeve të kryera, pasi Komisioni kërkoi<sup>94</sup> subjektit mbi rrethana që lidhen me këtë adresë banimi dhe faktin nënshkrimit të kontratës së qirasë për apartamentin në Tiranë, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se *kjo kontratë nuk është deklaruar prej saj, pasi realisht as kanë paguar qira, as kanë banuar ndonjëherë në atë adresë. Pavarësisht se ekzistonte formalisht, nuk është ekzekutuar nga asnjë prej palëve kontraktore dhe nuk ka prodhuar asnjë efekt. Arsyeya e hartimit të kësaj kontrate ishte një kërkesë e bërë pranë KLD nga ana e saj në atë periudhë për transferim në Gjykatën e Tiranës. Si qiradhënës në këtë kontratë paraqitet z. D.A, i cili është i afërmi i saj. Në bazë të asaj kontrate mundësohej të provohej për KLD-në vendbanimi në Tiranë, kusht pa të cilin transferimi i mundshëm në Gjykatën e Tiranës formalisht nuk mund të realizohej. Transferimi i të dhënave të gjendjes civile, në Tiranë u bë për po të njëjtin qëllim dhe formalisht ka qenë banore e Tiranës deri në 2014, ndërsa faktikisht ka vijuar jetesën dhe punën në qytetin e Gjirokastrës.*

**94.** Në analizë të deklaratimeve të bëra dhe dokumentacionit të administruar lidhur me këtë adresë banimi, rezulton se subjekti ka kryer veprime fiktive, me qëllim përfitimin e promovimit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**95.** Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime mbi ekzistencën e këtyre veprimeve fiktive, e në këtë kuadër të deklaratimeve kontradiktore të bëra mbi këtë adresë banimi.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit mbas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**96.** Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit dhe nëpërmjet shpjegimeve të dhëna në seancë dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se në bazë të rregullores së kohës së KLD-së, për t'u transferuar me detyrë në një rreth tjetër, nevojitej vendbanimi në atë qytet dhe se kjo është arsyeja e lidhjes së kontratës së qirasë me kushëririn D.A. Shkakun e mosdeklarimit të saj, subjekti e shpjegon bazuar në nenin 92/ç të Kodit Civil<sup>95</sup>, sipas të cilit veprimet fiktive ose të simuluar janë veprime që konsiderohen se nuk kanë ndodhur në kuptim të ligjit.

**97.** E pyetur në seancë dëgjimore se pse u lidh kjo kontratë me shtetasin D.A, ndërkohë që nëna e saj posedonte apartament banimi në qytetin e Tiranës, subjekti ka deklaruar se nëna mund të donte ta jepte me qira, të rrinte e vetme apo me nipin dhe mbesën dhe se nuk mund të qëndronin shumë persona në të njëjtën shtëpi.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**98.** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka pranuar kryerjen e veprimeve simuluese në lidhjen e marrëdhënies kontraktuale dhe, si rrjedhojë ka pranuar edhe deklarimin e rrethanave të rreme në formularët e ILDKPKI-së për vitet 2012 – 2014, mbi vendqëndrimin e saj, adresën tjetër të banimit. Nga ana tjetër rezulton se lidhja e kësaj kontrate qiraje me një person tjetër, e pranuar si e lidhur fiktivisht, në kushtet kur nëna e saj dispononte apartament banimi në Tiranë, tregon edhe një herë se subjekti i rivlerësimit ka dashur të shmangë lidhjet e saj me pasurinë në Tiranë dhe mundësinë e verifikimit të ligjshmërisë së burimeve financiare me të cilat është krijuar, për të cilën Komisioni krijoi bindjen se është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit.

**99.** Si përfundim, në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave të rezultuara gjatë hetimit në raport edhe me shpjegimet e subjektit, si dhe në referencë edhe të praktikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, trupi gjykues çmon se tërësia e veprimeve të subjektit të rivlerësimit tregojnë një raport të tillë të përkujdesjes së subjektit me zbatimin e ligjit, i cili është i papranueshëm për të pasur besimin e publikut. Rëndësia e sjelljes jashtëgjyqësore të gjyqtarit dhe ndikimi i saj në besimin e publikut te sistemi i drejtësisë është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri dhe pjesë e standardeve ndërkombëtare për sjelljen e gjyqtarëve, si Kodi i Etikës së Gjyqtarëve

<sup>94</sup> Pyetësori nr. 3, i dërguar nga Komisioni.

<sup>95</sup> Neni 92 /ç i Kodit Civil, “Veprime juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që...ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa patur për qëllim që të sjellin pasojë juridike (fiktive ose të simuluar)”.

të Republikës së Shqipërisë<sup>96</sup>, Parimet e Bangalores për Sjelljen Gjyqësore<sup>97</sup> e të tjera akte ndërkombëtare, si dhe e jurisprudencës së GJEDNJ-së<sup>98</sup>, të cilat theksojnë se shkelja e ligjit nga një gjyqtar jo vetëm dëmton reputacionin e funksionit si gjyqtar, por inkurajon mosrespektimin e ligjit dhe cenon besimin e publikut në integritetin e gjyqësorit.

## **Analiza financiare**

**100.** Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si edhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për periudhën nga fillimi detyrës deri në datën 31.12.2003, si edhe për çdo vit, për periudhën 2004 – 2016, nga ku duket se totali i balancës negative paraqitej në shumën prej 13.2 milionë lekë.

**100.1** Nga analiza paraprake e kryer rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të konstatuara për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2003, si edhe për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2010, 2011, 2014, 2015.

**101.** Pas kalimit të barrës së provës, Komisioni vëren se subjekti depozitoi shpjegime/argumentet e saj, si edhe prova të reja për të kundërshtuar rezultatet e analizës financiare, të cilat janë trajtuar gjërësisht në këtë vendim. Në vlerësim të prapësimeve të bëra nga subjekti, Komisioni reflektoi disa ndryshime në analizën financiare përfundimtare, të cilat gjenin mbështetje në dokumentacion ligjor provues<sup>99</sup>.

**102.** Si konkluzion, referuar analizës financiare përfundimtare rezultoi se subjekti paraqitet me një balancë negative fondesh, në total për vlerën rreth 11 milionë lekë, nga ku Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të konstatuara për periudhën nga fillimi i detyrës deri në datën 31.12.2003, si edhe për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2010, 2011, 2014, 2015, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” të ligjit nr. 84/2016.

## **Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimi tërësor i çështjes**

**103.** Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, si edhe ka kryer fshehje të pasurisë, duke u vendosur në kushtet parashikuara në gërmat “b”, dhe “c”, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>96</sup> Kodi i Etikës Gjyqësore 21, i miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare në datën 8.12.2006, në rregullën 3 parashikon: “Gjyqtari nuk duhet të lejojë që familja, të afërmit e tij apo persona të tjerë të influencojnë në punën dhe vendimet e tij. Ai nuk duhet të cenojë prestigjin e detyrës gjyqësore për hir të interesave privatë dhe në të njëjtën kohë nuk duhet t’u krijojë të tjerëve përshlyerje se vepron në mënyrë të tillë”.

<sup>97</sup> Komentari i Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, në paragrafin 108 shpjegon: “[...] Një gjyqtar është i detyruar të mbështesë ligjin. Ai ose ajo nuk duhet të vendoset në një pozicion konflikti në zbatim të ligjit. Çfarë të të tjerët mund të shihen si një shkelje relativisht e vogël, te gjyqtari mund të tërheqë publicitetin dhe të dëmtojë imazhin e gjyqtarit e të ngrrejë pikëpyetje në lidhje me integritetin e tij/saj dhe integritetin e gjyqësorit në tërësi.”

<sup>98</sup> GJEDNJ-ja, në çështjen *Baka k. Hungarisë* (Dhoma e Madhe 2016), është shprehur: “Gjykata në shumë raste ka theksuar rolin e veçantë të gjyqësorit, i cili, si një garantues i drejtësisë, njëherë nga vlerat themelore të shtetit të së drejtës, duhet të gëzojë besimin e publikut që të jetë i suksesshëm në kryerjen e detyrës së tij”.

<sup>99</sup> Referohu tabelës përmbledhëse të analizës financiare për periudhën 1995 – 2003 dhe për vitet 2004 – 2016, aneksi 1, pjesë e këtij vendimi.

**104.** Gjithashtu, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi Komisioni vlerësoi në tërësi të gjitha konstatimet e tjera që lidhen me kiterin e vlerësimit të pasurisë, krahas konstatimit të pasurisë së fshehur dhe mungesës së burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar në tërësi krijimin e pasurive dhe/apo kryerjen e shpenzimeve, arriti në përfundimin se ato janë të tilla që e çojnë këtë trup gjykues në konkluzionin se subjekti me veprimet e saj ka cënuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Pra, vlerësohet gjithashtu se vazhdimi i ushtrimit prej saj të funksionit të gjyqtarit do të ishte i papërshtatshëm dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 179, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për pasojë çon në zbatim të nenit 61, pika 5 të ligjit nr. 84/2016.

## **V. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, konkludon se:

- a) subjekti ka kryer fshehje të pasurisë;
- b) subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) subjekti ka cënuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë;

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si edhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar, nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe nenit 61, pika 3 dhe pika 5 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Blertha Marku (Çibuku), me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 26.9.2022.

### **TRUPI GJYKUES**

**Etleda Çiftja**

**Kryesuese**

**Suela Zhegu**

**Anëtare**

**Pamela Qirko**

**Relatore**

*Albana Plaka*

*Sekretare gjyqësore*

**ANEKS 1 - TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE, PERIUDHA, 1995 – 2003 dhe 2004 – 2016**

Analiza financiare përmbledhëse (Periudha / Vlerat në lekë)	1995-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>A) Pasuri</b>	<b>900,000</b>	<b>3,134,404</b>	<b>986,978</b>	<b>2,041,318</b>	<b>-5,470,536</b>	<b>436,465</b>	<b>299,847</b>	<b>578,894</b>	<b>2,049,111</b>	<b>290,670</b>	<b>274,011</b>	<b>910,233</b>	<b>520,559</b>	<b>47,594</b>
Apartament banimi me sip. 87,93 m2 i ndodhur në lagjen "*****", Gjirokastrë.	900,000													
Apartament banimi me sip. 73 m2 i ndodhur në lagjen "*****", Tepelenë.														
Automjet i markës ****, modeli E200 Kompresor, targa ***. I blerë në datë 12.12.2007.					250,000									
Automjet i markës *** me targa ***. I blerë në datë 14.8.2006.				247,406										
Truall me sip. 300 m2 I ndodhur në Sarandë.														
Apartament banimi me sip. 77 m2 i ndodhur në ***, Sarandë.														
Shtesa/pakesime likuiditete	0	3,134,404	986,978	1,793,912	-5,720,536	436,465	299,847	578,894	2,049,111	290,670	274,011	910,233	520,559	47,594
<b>B) Detyrime</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>C) Pasuri neto (A-B)</b>	<b>900,000</b>	<b>3,134,404</b>	<b>986,978</b>	<b>2,041,318</b>	<b>(5,470,536)</b>	<b>436,465</b>	<b>299,847</b>	<b>578,894</b>	<b>2,049,111</b>	<b>290,670</b>	<b>274,011</b>	<b>910,233</b>	<b>520,559</b>	<b>47,594</b>
<b>D) Të ardhura</b>	<b>3,000,074</b>	<b>878,775</b>	<b>773,605</b>	<b>965,134</b>	<b>1,163,611</b>	<b>892,687</b>	<b>1,097,865</b>	<b>1,032,538</b>	<b>990,791</b>	<b>1,168,493</b>	<b>1,179,613</b>	<b>1,440,460</b>	<b>1,543,827</b>	<b>1,569,348</b>
Të ardhura nga paga subjekti i rivlerësimit	2,722,247	878,775	526,795	837,333	870,140	892,687	1,097,865	1,032,538	990,791	1,092,673	1,179,613	1,440,460	1,433,769	1,443,566
Të ardhura nga leja e lindjes subjekti I rivlerësimit	133,489		169,652											
Të ardhura nga puna e bashkëshortit në emigracion	144,338													
Të ardhura nga puna e bashkëshortit gjatë viteve 2007-2016														
Të ardhura nga babai I SR para cash në vlerën 10,000 euro (në ruajtje)														
Të ardhura nga babai I SR (trashëgimi) sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore 15.09.2014.														
Të ardhura nga shitja e automjetit të markës ***, targë ***. Datë 4.12.2007					250,000									
Të ardhura nga interesat bankare			77,158	127,801	43,471					75,820			60,058	25,782
Të ardhura nga dhurimi i të afërmeve për fëmijët													50,000	100,000
<b>E) Shpenzime</b>	<b>2,376,047</b>	<b>468,154</b>	<b>646,005</b>	<b>2,349,190</b>	<b>7,522,150</b>	<b>577,193</b>	<b>570,425</b>	<b>568,581</b>	<b>1,030,871</b>	<b>771,461</b>	<b>568,006</b>	<b>984,119</b>	<b>1,144,161</b>	<b>1,257,119</b>
Shpenzime për blerje apartamenti në Selitë, Tiranë me nr. pasurie ***, sip 95 m2.					6,770,960									
Shpenzime/pagesat e kryera nga bashkëshorti I SR në favor të shoqërisë *** shpk.				1,764,200										
Shpenzime për përshatje të banesës karabina për apartamentin në Gjirokastrë	1,647,859													
Shpenzime mobilimi sipas deklartimit ne pyetesor nr.1		240,000	200,000	110,000	150,000									
Shpenzime për ndjekjen e masterit subjekti I rivlerësimit									207,450	139,720				
Shpenzime për pushimet verore													100,000	
Shpenzime jetike	728,188	187,928	438,228	438,228	546,480	546,480	546,480	546,480	546,480	558,192	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime udhëtimi jashtë vendit	0	40,226	7,777	36,762	54,710	30,713	23,945	22,101	276,941	73,549	3,910	104,127	147,057	316,751
<b>Balanca e fondeve (D-C-E)</b>	<b>-275,973</b>	<b>-2,723,783</b>	<b>-859,379</b>	<b>-3,425,374</b>	<b>-888,003</b>	<b>-120,971</b>	<b>227,592</b>	<b>-114,937</b>	<b>-2,089,191</b>	<b>106,363</b>	<b>337,596</b>	<b>-453,892</b>	<b>-120,893</b>	<b>264,634</b>